

*Qendra Botuese Shoqata e Jezuitëve*



*LETËR APOSTOLIKE  
NOVO MILLENNIO INEUNTE  
E PONTIFEKSIT MË TË LARTË  
GJON PALI II  
IPESHKVIJVE, KLERIT DHE  
BESIMTARËVE  
NË FUND TË JUBILEUT TË MADH  
TË VITIT DYMIJË*



*Bashkëvëllezërve Ipeshkvij,  
Meshtarëve dhe diakonëve,  
Rregulltarëve dhe rregulltareve,  
Të gjithë besimtarëve laikë.*

1. Në fillim të mijëvjeçarit të ri, ndërsa mbyllet Jubileu i Madh në të cilin kemi kremtuar dymijë vjetët e lindjes së Jezusit dhe një shteg i ri ecjeje hapet për Kishën, duke bërë të jehojnë në zemrën tonë fjalët me të cilat, një ditë, Jezusi, pasi u kishte folur turmave nga barka e Simonit, e ftoi Apostullin të “shkojnë larg” për të peshkuar: “Grahi në ujë të thellë” (Lk 5,4). Pjetri e shokët e parë iu besuan fjalës së Krishtit dhe i hodhën rrjetat. “E si bënë kështu zunë një sasi të madhe peshqish” (Lk 5,6).

Grahi në ujë të thellë! Kjo fjalë tingëllon sot për ne dhe na fton të kujtojmë me mirënjohje të kaluarën, të jetojmë me pasion të tashmen, t’i hapemi me besim të ardhmes: “Jezu Krishti është i njëjti, dje, sot e gjithmonë!” (Heb 13,8).

I madh ka qenë këtë vit gëzimi i Kishës, që është përkushtuar për të soditur fytyrën e Dhëndrit e Zotërisë së saj. Ajo është bërë më fort se kurrë popull shtegtues, i udhëhequr nga Ai që është “Bari i madh i deleve” (Heb

13,20). Me një dinamikë të jashtëzakonshme, që ka përfshirë shumë anëtarë të tij, Populli i Hyjit, këtu në Romë, ashtu si në Jerusalem e në çdo kishë ka kaluar përmes “Portës së Shenjtë” që është Krishti. Atij, pikëmbërritje e historisë dhe Shpëtimtar i vetëm i botës, Kisha dhe Shpirti i kanë thërritur: “*Marana tha – Eja, Zot Jezus*” (krh Zb 22,17.20; 1 Kor 16,22).

Është e pamundur të matet ngjarja e hirit që, përgjatë vitit, ka prekur ndërgjegjet. Por sigurisht, “një lumë uji të gjallë”, ai që përjetësisht buron “nga fronti i Hyjit dhe i Qengjit” (krh Zb 22,1), është derdhur përmbi Kishën. Është uji i Shpirtit që shuan etjen e përtërin (krh Gjn 4,14). Është dashuria e mëshirshme e Atit që, në Krishtin, na është edhe një herë zbuluar e dhuruar. Në mbarim të këtij viti mund të përsërisim, me ngazëllim të ri, fjalën e lashtë të mirënjohjes: “Kremtoni Zotin sepsë është i mirë, sepsë e amshuar është mëshira e tij” (Ps 118[117],1).

2. Prandaj ndjej nevojën t’ju drejtohem juve, shumë të dashur, për të bashkëndarë këngën e lavdërimit. Këtë Vit të Shenjtë të Dymijës e kisha menduar si një term kohor të rëndësishëm, qysh prej fillimit të Ponifikatit tim. Kisha kapur, në këtë kremtim, një takim provanor, në të cilin Kisha, tridhjetepesë vjet nga Konçili Ekumenik Vatikan II, do të ftohej të pyetej mbi përtëritjen e saj për të rimarrë me hov të ri misionin e saj ungjillizues.

A mund të quhet i suksesshëm Jubileu në këtë pikëpamje? Angazhimi ynë, me përpjekjet e veta bujare dhe brishtësitë e pamungueshme, është përpara vështrimit

të Hyjit. Por nuk mund të tërhiqemi nga detyra e mirënjohjes për “mrekullitë” që Hyji ka kryer për ne. “*Misericordias Domini in aeternum cantabo*” (Ps 89 [88],2).

Në të njëjtën kohë, çka ka ndodhur nën sytë tanë kërkon që të rikonsiderohet dhe, në një farë kuptimi, të deshifrohet, për të dëgjuar atë që Shpirti, përgjatë këtij viti kaq intensiv, i ka thënë Kishës (krh Zb 2,7.11.17 etj.).

3. Sidomos, shumë të dashur Vëllezër e Motra, është detyrë për ne që të projektohemi drejt së ardhmes që na pret. Shumë herë, në këta muaj, kemi vështuar për nga mijëvjeçari i ri që hapet, duke e jetuar Jubileun jo vetëm si *kujtim të së kaluarës* por si *profeci të së ardhmes*. Duhet tani ta ruajmë si thesar hirin e marrë, duke e përkthyer në zell qëllimesh dhe linjash konkrete vepruese. Një detyrë për të cilën dëshiroj të ftoj të gjitha Kishat lokale. Në secilën prej tyre, të mbledhur rreth Ipeshkvit të vet, në dëgjimin e Fjalës, në bashkimin vëllazëror dhe në “thyerjen e bukës” (krh Vap 2,42), është “vërtet e pranishme dhe vepron Kisha e Krishtit, e vetme, e shenjtë, katolike dhe apostolike”<sup>1</sup>. Është sidomos në konkretësinë e secilës Kishë që misteri i popullit të vetëm të Hyjit merr atë përtrajtësim të posaçëm që e bën të përshtatshëm për kontekstet dhe kulturat e veçanta.

---

<sup>1</sup> Konc. Ecum. Vat. II, Decr. Mbi detyrën baritore të Ipeshkvijve *Christus Dominus*, 11.

Kjo rrënjosje e Kishës në kohë dhe në hapësirë reflekton, në analizë të fundit, vetë *lëvizjen e Mishërimit*. Është koha pra që secila Kishë, duke reflektuar mbi çka Shpirti i ka thënë popullit të Hyjit në këtë vit të veçantë hiri, dhe madje në harkun kohor më të gjatë që shkon nga Konçili Vatikan II në Jubileun e Madh, të kryejë një verifikim të zellit të vet dhe të rifitojë hov të ri për angazhimin e vet shpirtëror e baritor. Është për një qëllim të tillë që dëshiroj të ofroj në këtë Letër, në përfundim të Vitit jubilar, kontributin e detyrës sime pjetrore, në mënyrë që Kisha të shkëlqejë gjithnjë e më shumë në shumëllojshmërinë e dhuratave të saj dhe në njësinë e ecjes së saj.

## I TAKIMI ME KRISHTIN - TRASHËGIMI E JUBILEUT TË MADH

4. Po të falenderojmë o Zotëri, Hyj i gjithëpushtetshëm” (Zb 11,17). Në Bulla e shpalljes së Jubileut uroja që kremtimi dymijëvjeçar i misterit të Mishërimit të jetohej si “një e vetme, e pandërprerë, këngë lavdërimi drejtuar Trinisë”<sup>2</sup> dhe njëkohësisht “si ecje pajtimi dhe si shenjë shprese të pastër për të gjithë ata që shohin drejt Krishtit dhe Kishës së tij”.<sup>3</sup> Përvoja e

---

<sup>2</sup> Bulla Incarnationis Misterium (29 nëntor 1998), 3: AAS 91 (1999), 132

<sup>3</sup> Po aty., 4: l.c., 133.



Vitit jubilar është trajtësuar pikërisht sipas këtyre përmasave jetësore, duke arritur momente intensiteti që na kanë bërë ta prekim me dorë pothuajse praninë e mëshirshme të Hyjit, nga i cili “zbret çdo dhuratë e mirë dhe çdo dhunti e përsosur” (Jak 1,17).

Mendoj për përmasën e lavdërimit, para së gjithash. Është së këtejmi në fakt që lëviz çdo përgjigje e përnjëmendtë besimi ndaj zbulimit të Hyjit në Krishtin. Krishtërimi është hir, është surpriza e një Hyji që, jo i kënaqur plotësisht së krijuari botën dhe njeriun, u vu të ecë me krijesën e vet, dhe pasi i kishte folur disa herë e në mënyra të ndryshme “përmes profetëve, në fund, në këto ditë, na ka folur neve përmes Birit” (Heb 1, 1-2).

*Në këto ditë!* Po, Jubileu na ka bërë të ndjejmë se dymijë vjet historie kanë kaluar pa e zbehur freskinë e atij “sot”-i me të cilin engjëjt u lajmëruan barinjve ngjarjen e mrekullueshme të lindjes së Jezusit në Betlehem: “Sot, në qytet të Davidit ju lindi Shëlbuesi – Krishti Zot!” Lk 2,11). Dymijë vjet kanë kaluar, por mbetet më shumë se kurrë e gjallë shpallja që Jezusi bëri për misionin e vet përpara bashkëqytetarëve të vet të mahnitur në Sinagogën e Nazaretit, duke ia mveshur vetvetes profecinë e Isaisë: “Sot shkoi në vend kjo pjesë e Shkrimit Shenjt që e dëgjuat me veshët tuaj” (Lk 4,21). Dymijë vjet kanë kaluar, por kthehet gjithnjë ngushëlluese për mëkatarët nevojtarë për mëshirë – e kush nuk është? – ai “sot” i shpëtimit që mbi kryq ia hapi dyert e Mbretërisë së Qiellit cubit të penduar: “Për të

vërtetë po të them: sot do të jesh me mua në Parajsë” (Lk 23, 43).

### ***Plotësia e kohës***

5. Koinçidenca e këtij Jubileu me hyrjen në një mijëvjeçar të ri i ka dhënë dorë sigurisht, pa asnjë rënie në fantazi mijëvjeçariste, përceptimit të misterit të Krishtit në horizontin e madh të historisë së shpëtimit. *Krishtërimi është religjion i zbritur në histori!* Është mbi terrenin e historisë në fakt, që Hyji ka dashur të vendosë me Izraelin një besëlidhje dhe të përgatisë kështu lindjen e Birit në barkun e Marisë në “plotësinë e kohës” (Gal 4,4). I kapur në misterin e tij hyjnor e njerëzor, Krishti është themeli dhe qendra e historisë, është kuptimi i saj dhe qëllimi i fundit. Është përmes tij në fakt, Fjalë dhe shëmbëllim i Atit, që “u bë çdo gjë” (Gjn 1,3; krh Kol 1,15). Mishërimi i tij, që kulmon në misterin pashkor dhe në dhuratën e Shpirtit, përbën zemrën që rreh në kohë, orën e mistershme në të cilën Mbretëria e Hyjit është bërë e afërt (krh Mk 1,15), madje ka hedhur rrënjë, si farë e destinuar për t’u bërë një pemë e madhe (krh Mk 4,30-32), në historinë tonë.

“Lavdi ty, Krishti Jezus, mbreti ynë je përjetë e mot”. Me këtë këngë mijëra herë të përsëritur, kemi soditur Krishtin këtë vit ashtu siç na e paraqet Zbulesa: “Unë jam Alfa dhe Omega, i Pari dhe i Fundit, Fillimi dhe Mbarimi” (Zb 22,13). Dhe duke kundruar Krishtin kemi soditur së bashku Atin dhe Shpirtin, Trininë e vetme dhe

të pandarë, mister i pashprehshëm në të cilin gjithçka ka origjinën e vet dhe gjithçka përkryerjen e vet.

### ***Pastrim i kujtesës***

6. Në mënyrë që syri ynë të mund të ishte më i pastër për të soditur misterin, ky Vit jubilar ka qenë fort i karakterizuar nga kërkesa e faljes. Dhe kjo ka qenë e vërtetë jo vetëm për individët, që kanë pyetur veten mbi jetën e vet, për të lypur mëshirë dhe për të marrë dhuratën e posaçme të ndjesës, por për mbarë Kishën, që ka dashur të kujtojë pabesitë me të cilat shumë bij të saj, përgjatë historisë, kanë hedhur hije mbi fytyrën e saj si Nuse e Krishtit.

Këtij shqyrtimi të ndërgjegjes i ishim nënshtruar për një kohë të gjatë, të vetëdijshëm se Kisha, duke përfshirë në gjirin e saj mëkatarët, është “e shenjtë e gjithnjë nevojtare për purifikim”<sup>4</sup> Kuvende shkencore na kanë ndihmuar për të vënë në fokus ato aspekte në të cilat shpirti ungjillor, përgjatë dy mijëvjeçarëve të parë, nuk ka shkëlqyer gjithmonë. Si mund të harrohet Liturgjia prekëse e 12 marsit 2000, në të cilën unë vetë, në Bazilikën e shën Pjetrit, duke ngulitur vështrimin mbi të kryqëzuarin, u bëra zë i Kishës duke kërkuar falje për mëkatin e të gjithë bijve të saj? Ky “pastrim i kujtesës” i ka forcuar hapat tanë në ecjen drejt të ardhmes, duke na bërë së bashku më të përvuajtur dhe vigjilentë në përputhjen tonë me Ungjillin.

---

<sup>4</sup> Konc. Ecum. Vat. II, Kusht. dogm. mbi Kishën *Lumen Gentium*, 8.

### ***Dëshmitarë të fesë***

7. Ndërgjegjja e gjallë pendestare, gjithësesi, nuk na ka penguar për t'i dhënë lavdi Zotit për sa ka kryer në të gjithë shekujt, e veçanërisht në shekullin që kemi lënë pas krahëve, duke i siguruar Kishës së vet një aradhe të madhe shenjtërisht e martirësh. Për disa prej tyre Viti jubilar ka qenë edhe viti i lumturimit ose i kanonizimit. Në referim me Papë mjaft mirë të njohur nga historia ose me figura të përvuajtura laikësh e rregulltarësh, nga një kontinent në tjetrin të globit, shenjtëria është shfaqur më fort se kurrë si përmasa që e shpreh më mirë misterin e Kishës. Mesazh shprehës që nuk ka nevojë për fjalë, ajo e paraqet të gjallë fytyrën e Krishtit.

Shumë është bërë pastaj, me rastin e Vitit të Shenjtë, për të mbledhur *kujtimit e çmuara të dëshmitarëve të fesë në shekullin XX*. I kemi përkujtuar më 7 maj 2000, së bashku me përfaqësuesit e Kishave e Bashkësive kishtarë të tjera, në skenarin sugjestiv të Koloseut, simbol i përndjekjeve të lashta. Është një trashëgimi për të mos u shkapërdarë, për t'u dorëzuar ndaj një detyre të përhershme mirënjohjeje dhe një qëllimi të përtërirë imitimi.

### ***Kishë shtegtare.***

8. Gati duke u vënë në gjurmët e Shenjtërve, kanë ardhur njeri pas tjetrit këtu në Romë bij të panumërt të Kishës, me dëshirën për të shpallur fenë e vet, për të rrëfyer mëkatet e veta dhe për të marrë mëshirën që shpëton. Vështrimi im këtë vit nuk ka mbetur i mahnitur

vetëm nga turmat që kanë mbushur sheshin e shën Pjetrit gjatë shumë kremtimeve. Jo rrallë jam ndalur për të parë radhët e gjata të shtegtarëve në pritje plot durim për të kapërcyer Portën e Shenjtë. Në secilin prej tyre kërkoja të përfytyroja një histori jete, të bërë prej gëzimesh, ankthesh, dhimbjesh; një histori të takuar nga Krishti, dhe që në dialogun me të rimerrte ecjen e saj të shpresës.

Duke vërejtur pastaj rrjedhën e vazhdueshme të grupeve, nxirrja së këtejmi një si imazh të prekshëm të Kishës shtegtare, të asaj Kishe të vendosur, siç thotë shën Agustini, “midis përndjekjeve të botës dhe ngushëllimeve të Hyjit”<sup>5</sup>. Neve nuk na është dhënë të vërejmë veçse fytyrën më të jashtme të kësaj ndodhie unike. Kush mund t’i masë mrekullitë e hirit që janë realizuar në zemrat? Më mirë të heshtësh e të adhurosh, duke i besuar përvujtërisht veprimit të mistershëm të Hyjit dhe duke kënduar dashurinë e tij pa fund: “*Misericordias Domini in aeternum cantabo!*”.

### ***Të rinjtë***

9. Takimet e shumta jubilarë kanë parë të tubohen kategoritë më të ndryshme të personave, duke regjistruar një pjesëmarrje me të vërtetë mbresëlënëse, që nganjëherë e ka vënë në provë të vështirë angazhimin e organizatorëve dhe të animatorëve, si kishtarë ashtu edhe civilë. Dëshiroj të përfitoj nga kjo Letër për t’u shprehur

---

<sup>5</sup> De civ. Dei XVIII, 51,2: PL 41,614; krh Conc Ecum Vat. II, Kost Dogm mbi Kishën Lumen Gentium, 8.

të gjithëve falënderimin tim më të përzemërt. Por përtej numrit, çka shumë herë më ka prekur ka qenë konstatimi i angazhimit serioz për lutje, për reflektim, për bashkim, që këto takime kanë dëftuar përgjithësisht.

E si të mos kujtoj veçanërisht takimin e gëzueshëm dhe entuziazmues të të rinjve? Nëse ka një imazh të Jubileut të Vitit 2000 që më shumë se të tjerë do të mbetet i gjallë në kujtesë, sigurisht është ai i morisë së të rinjve me të cilët kam mundur të vendos një lloj dialogu të privilegjuar, mbi bazën e një simpatie të ndërsjellë dhe të një mirëkuptimi të thellë. Ka qenë kështu që nga mirëseardhja që u kam dhënë atyre në Sheshin shën Gjoni në Laterano dhe në Sheshin shën Pjetri. Pastaj i kam parë të shkojnë në luzma nëpër qytet, gazmorë siç duhet të jenë të rinjtë, por edhe të menduar, të dëshiruar për t'u lutur, për "kuptim", për miqësi të vërtetë. Nuk do të jetë e lehtë, as për ata vetë, as për ata që i kanë vërejtur, të shlyejnë nga kujtesa atë javë kur Roma qe bërë "e re me të rinjtë". Nuk do të jetë e lehtë të harrohet kremtimi eukaristik i Tor Vergata-s.

Edhe një herë të rinjtë u treguan për Romën dhe për Kishën si Një dhuratë e posaçme e Shpirtit të Hyjit. Ka nganjëherë, kur hidhet vështrimi mbi të rinjtë, me problemet e brishtësitë që i shënojnë në shoqëritë bashkëkohore, një prire për pesimizëm. Jubileu i të rinjve në një farë mënyre na ka lënë gojëkyçur, ndërsa na ka dorëzuar mesazhin e një rinie që shpreh një dëshirë të thellë, pavarësisht nga dykuptimësi të mundshme, për ato vlera autentike që kanë në Krishtin plotësinë e tyre. A

mos nuk është Krishti sekreti i lirisë së vërtetë dhe i gëzimit të plotë të zemrës? A nuk është Krishti miku më i lartë dhe njëkohësisht edukuesi i çdo miqësie të përnjëmendtë. Nëse të rinjve Krishti u paraqitet me fytyrën e tij të vërtetë, ata e ndjejnë si një përgjigje bindëse dhe janë të aftë ta përqafojnë mesazhin e saj, edhe pse kërkues e të shënuar nga Kryqi. Për këtë, duke u dridhur prej entuziazmit të tyre, nuk kam hezituuar t'u kërkoj atyre një zgjedhje rrënjësore feje dhe jete, duke kallëzuar një detyrë të mahnitshme: atë që të bëhen “roje të mëngjesit” (krh Is 21,11-12) në këtë agim të mijëvjeçarit të ri.

### ***Shtegtarë të kategorive të ndryshme***

10. Nuk mund të ndalem natyrisht në hollësi mbi secilën prej ndodhive jubilarë. Secila prej tyre ka pasur karakterin e vet dhe u ka lënë mesazhin e vet jo vetëm atyre që kanë marrë pjesë drejtpërdrejt, por edhe atyre që kanë marrë vesh ose kanë marrë pjesë në to përmes mass media-ve. Po si të mos kujtohet toni festiv i takimit të parë të madh kushtuar fëmijëve? Të filloja me ta do të thoshte në një farë mënyre të respektoja vërejtjen e Jezusit:

“Lërimi fëmijët të vijnë tek unë” (Mk 10,14). Do të thoshte ndoshta akoma më shumë të përsërisja gjestin që ai kreu, kur “vuri në mes” një fëmijë dhe e bëri atë vetë simbolin e qëndrimit për t'u mbajtur, nëse duam të hyjmë në Mbretërinë e Hyjit (krh Mt 18, 2-4).

Kështu, në një farë mënyre, është në gjurmët e fëmijëve që kanë ardhur për të kërkuar mëshirën jubilarë kategoritë më të ndryshme të të rriturve: nga të moshuarit e sëmurë dhe të paaftë, nga punëtorët e ofiçinave dhe të fushave tek sportistët, nga artistët tek pedagogët, nga Ipeshkvijtë dhe priftërinjtë tek personat e jetës së shuguruar, nga politikanët tek gazetarët deri tek ushtarakët, të ardhur për të ripohuar kuptimin e shërbimit të tyre si një shërbim për paqen.

Një frymëmarrje të gjerë pati tubimi i punëtorëve, i zhvilluar më 1 maj në ditën tradicionale të festës së punës. Atyre u kërkova që ta jetonin shpirtërinë e punës, në imitim të shën Jozefit dhe të vetë Jezusit. Jubileu i tyre më ofroi gjithashtu rastin për të shqiptuar një ftesë të fortë shërim çekuilibrave ekonomikë dhe shoqërorë që ekzistojnë në botën e punës, dhe për një qeverisje me vendosmëri të proceseve të globalizimit ekonomik në funksion të solidaritetit dhe të respektit që i detyrohem i çdo personi njerëzor.

Fëmijët, me festivitetin e tyre të papërmbajtshëm, janë rikthyer në Jubileun e Familjeve, në të cilin i janë treguar botës si “pranverë e familjes dhe e shoqërisë”. Me të vertetë shprehës ka qenë ky takim jubilar në të cilin shumë familje, të prejardhura nga krahina të ndryshme të botës, kanë ardhur për të marrë me zell të përtërirë dritën e Krishtit mbi planin zanafillës të Hyjit lidhur me ta (krh 10, 19, 4-6). Ato janë angazhuar për ta rrezatuar atë drejt një kulture që rrezikon ta humbasë në mënyrë gjithnjë e



më preokupuese vetë kuptimin e martesës dhe të institutit familjar.

Ndër takimet më prekëse, pastaj, mbetet për mua ai që kam pasur me botën e spektaklit, që aq forcë tërheqëse ushtron mbi shpirtin e njerëzve. Personave të përfshira në këtë sektor u kam kujtuar përgjegjësinë e madhe për të propozuar, me argëtimin e hareshëm, mesazhe pozitive, moralisht të shëndosha, të afta për të frymëzuar besim dhe dashuri për jetën.

### ***Kongresi Eukaristik Ndërkombëtar***

11. Në logjikën e këtij viti jubilar, një kuptim cilësues duhej të kishte Kongresi Eukaristik Ndërkombëtar. Dhe e ka pasur! Nëse Eukaristia është flija e Krishtit që bëhet i pranishëm midis nesh, a mundëj prania e tij reale të mos ishte në qendër të Vitit të Shenjtë të kushtuar mishërimit të Fjalës? Qe parashikuar, pikërisht për këtë, si vit “intensivisht eukaristik”<sup>6</sup> dhe kështu jemi përpjekur ta jetojmë. Në të njëjtën kohë, si mund të mungonte, krahas kujtimit të lindjes së Birit, ai i Nënës? Maria ka qenë e pranishme në kremtimin jubilar jo vetëm përmes Kuvendesh të dobishëm e cilësorë, por sidomos përmes Aktit të madh të besimit me të cilin, i përkrahur nga një pjesë e mirë e Episkopatit botëror, ia kam dorëzuar përkujdesjes së saj mëmësorë jetën e burrave dhe të grave të mijëvjeçarit të ri.

---

<sup>6</sup> Krh Gjon Pali II, Let. Ap. Tertio millennio adveniente (10 nëntor 1994), 55: AAS 87 (1995), 38.

### ***Përmasa ekumenike***

12. Do të kuptohet se më vjen e natyrshme të flas për Jubileun sidomos si të parë prej selisë së Pjetrit. Nuk harroj gjithësesi se kam dashur unë vetë që krentimi i tij të zhvillohej me të njëjtën vlerë edhe në Kishat e veçanta, dhe është atje që pjesa më e madhe e besimtarëve ka mundur të marrë huret e posaçme dhe, në veçanti, ndjesën e lidhur me Vitin jubilar. Mbetet gjithësesi kuptimplotë që Dioqeza të shumta kanë ndjerë dëshirën për t'u bërë të pranishme, me grupe të mëdha besimtarësh, edhe këtu në Romë. Qyteti i përjetshëm ka dëftuar kështu edhe një herë rolin e tij providencial si vend në të cilin pasuritë dhe dhuratat e çdo Kisha e madje të çdo kombi e kulture të vetme, harmonizohen në “katolicitetin”, kështu që Kisha e vetme e Krishtit ta dëftojë në mënyrë gjithnjë e më shprehëse misterin e saj si sakrament njësimi.<sup>7</sup>

Një vëmendje e posaçme kisha kërkuar që të rezervohej në programin e Vitit Jubilar edhe për *përmasën ekumenike*. Ç’rast më i volitshëm, për të inkurajuar ecjen drejt bashkimit të plotë, se krentimi i përbashkët i lindjes së Krishtit? Shumë përpjekje janë kryer për një qëllim të tillë dhe mbetet i ndritshëm takimi ekumenik në Bazilikën e shën Palit, më 18 janar 2000, kur për herë të parë në histori, *një Portë e shenjtë ka qenë hapur bashkarisht* nga Pasardhësi i Pjetrit, nga Primati

---

<sup>7</sup> Krh Konc. Ekum Vat. II, Kusht. Dogm. Mbi Kishën *Lumen Gentium*, 1.

Anglikan dhe nga një Metropolit i Patriarkatit Ekumenik të Konstandinopojës, në prani përfaqësuesish të Kishave e Bashkësive kishtare të të gjithë botës. Në këtë linjë kanë shkuar edhe disa takime të rëndësishme me Patriarkë ortodoksë dhe Krerë besimesh të tjera të krishtera. Kujtoj, në veçanti, vizitën para pak kohësh të Sh.T. Karekin II, Patriark i Epërm dhe Katholikos i të gjithë armenëve. Gjithashtu shumë besimtarë Kishash të tjera dhe Bashkësish kishtare kanë marrë pjesë në takimet jubilarë të kategorive të veçanta. Ecja ekumenike mbetet sigurisht e lodhshme, ndoshta e gjatë, por na gjallëron shpresa e të qenit të prirë nga prania e të Ringjallurit dhe nga forca e pashtershme e Shpirtit të tij, e aftë për surpriza gjithnjë të reja.

### *Shtegtimi në Tokën e Shenjtë*

13. E si të mos kujtoj pastaj Jubileun tim personal mbi rrugët e Tokës së Shenjtë. Do të kisha dashur ta filloja në Ur të Kaldenjve, për t'u vënë gati në mënyrë të ndjeshme në gjurmët e Abrahamit “atit tonë në fe” (krh Rm 4,11-16). Por m'u desh të kënaqem me një etapë vetëm shpirtërore, me sugjestiven “Liturgji të Fjalës” të kremtuar më 23 shkurt në Sallën Pali VI. Erdhi menjëherë më pas shtegtimi i përnjëmendtë, duke ndjekur itinerarin e historisë së shpëtimit. Pata kështu gëzimin të ndalesha në Malin Sinai, në skenarin e dhurimit të Dekalogut dhe të Besëlidhjes së parë. E rinisa ecjen një muaj më vonë, duke prekur Malin Nebo dhe duke u kthyer pastaj në të njëjtat vende të banuara dhe të

shenjtëruara nga Shëlbuesi. Është e vështirë të shprehësh mallëngjimin që kam provuar ndërsa nderoja vendet e lindjes dhe të jetës së Krishtit, në Betlehem dhe Nazaret, duke kremtuar Eukaristinë në Çenakull, në të njëjtin vend të themelimit të saj, duke rimedituar misterin e Kryqit mbi Golgotë, ku Ai ka dhënë jetën për ne. Në ato vende, akoma aq të trazuara dhe edhe në kohët e fundit të fshikulluara nga dhuna, kam mundur të provoj një mikpritje të jashtëzakonshme jo vetëm nga ana e bijve të Kishës, por edhe nga ana e bashkësisë izraelite e palestineze. I fortë ka qenë pastaj emocioni im në lutjen pranë Murit të Vajtimit dhe në vizitën në Mauzoleun e Yad Vashem, kujtim ngjethës i viktimave të kampeve naziste të shfarosjes. Ai shtegtim ka qenë një moment vëllazërimi dhe paqeje, që më pëlqen ta mbaj mend si një prej dhuratave më të bukura të ndodhisë jubilarë. Duke rimenduar klimën e përjetuar në ato ditë, nuk mund të mos shpreh urimin e ndjerë për një zgjidhje të shpejtë e të drejtë të problemeve ende të hapura në ato vende të shenjta, bashkarisht të dashura për hebrenjtë, të krishterët dhe myslimanët.

### ***Borxhi ndërkombëtar.***

14. Jubileu ka qenë edhe – dhe nuk mund të ishte ndryshe – një ngjarje e madhe dashurie. Që nga vitet përgatitore, kisha bërë thirrje për një vëmendje më të madhe e vepruese ndaj problemeve të varfërisë që ende mundojnë botën. Një kuptim të posaçëm ka marrë, në këtë skenar, problemi i borxhit ndërkombëtar të Vendeve

të varfra. Kundrejt këtyre të fundit, një gjest bujarie ishte në vetë logjikën e Jubileut, i cili në konfigurimin e vet fillestar biblik ishte pikërisht koha në të cilën bashkësia angazhohej për të rivendosur drejtësinë e solidaritetin në raportet mes personave, duke kthyer edhe të mirat materiale të përvetësuara. Kam qenë i gëzuar të vërej se kohët e fundit Parlamentet e shumë prej shteteve kreditore kanë votuar një falje thelbësore të borxhit të dyanshëm në ngarkim të Vendeve më të varfra dhe të hyra në borxh. Kërkoj shprehimisht që Qeveritë përkatëse t'i vënë në zbatim, në një kohë të shkurtër, këto vendime parlamentare. Ndërsa më fort problematike është treguar çështja e borxhit të shumëanshëm, kontraktuar nga vendet më të varfra me Organizmat financiarë ndërkombëtarë. Është për t'u uruar që Shtetet anëtare të këtyre Organizatave, sidomos ato që kanë një peshë më të madhe vendimmarrëse, të arrijnë të gjejnë konsensuset e nevojshme për të arritur në zgjidhjen e shpejtë të një çështjeje nga e cila varet ecja e zhvillimit të shumë Vendeve, me rrjedhoja të rënda për gjendjen ekonomike dhe ekzistenciale të shumë personave.

### *Një dinamizëm i ri*

15. Janë këto vetëm disa prej linjave që spikasin nga përvoja jubilarë. Ajo le shumë mbresa në kujtesën tonë. Por nëse do të donim ta çonim në thelbin e vet qenësor trashëgiminë e madhe që ajo na dorëzon, nuk do të hezitohet ta individualizojë në *soditjen e fytyrës së Krishtit*: ai i konsideruar në përvijimet e tij historike dhe

në misterin e tij, i mikpritur në praninë e tij të shumëfishtë në Kishë e në botë, i shpallur si kuptim i historisë dhe dritë e ecjes sonë.

Tani duhet të shikojmë përpara, duhet të “grahim larg”, me besim në fjalën e Krishtit: *Duc in altum!* Çka kemi bërë këtë vit nuk mund të justifikojë një ndjesi vetëkënaqjeje dhe akoma më pak të na sjellë tek një qëndrim mosangazhimi. Përkundrazi, përvojat e jetuara duhet të ngjallin në ne një dinamizëm të ri, duke na shtyrë për ta investuar entuziazmin që kemi provuar në nisma konkrete. Vetë Jezusi na paralajmëron: “Kushdo që vë dorën në parmendë dhe sillet e shikon mbrapa, nuk është i përshtatshëm për mbretërinë e Hyjit” (Lk 9,62). Në çështjen e Mbretërisë nuk ka kohë për të parë pas, aq më pak për t’u rehatuar në dembeli. Shumë na pret dhe duhet për këtë të shtiem në dorë një programim të efektshëm baritor post-jubilar.

Është gjithësesi e rëndësishme që gjithë sa do të propozojmë, me ndihmën e Hyjit, të jetë thellësisht e rrënjosur në soditje dhe në lutje. Kjo e jona është një kohë lëvizjeje të vazhdueshme që arrin shpesh deri në shqetësim, me rrezikun e lehtë të të bërit për të bërë”. Duhet t’i rezistojmë këtij tundimi, duke kërkuar të “jemi” para se “të bëjmë”. Të kujtojmë lidhur me këtë qortimin e Jezusit për Martën: “...ti po brengosesh e po shqetësohesh për shumë gjëra, por një e vetme është gjëja për të cilën ka nevojë” (Lk, 41-42). Në këtë shpirt, para se t’i propozoj konsiderimit tuaj disa linja veprimi, dëshiroj

t'ju përcjell ndonjë shkas meditimi mbi misterin e Krishtit, themel absolut i çdo veprimi tonë baritor.

## II NJË FYTYRË PËR T'U SODITUR

16. “Duam të shohim Jezusin” (Gjn 12,21) Kjo kërkesë, bërë apostullit Filip nga disa Grekë që kishin shkuar në Jerusalem për shtegtimin pashkor, ka rijehuar shpirtërisht edhe në veshët tanë në këtë Vit jubilar. Si ata shtegtarë të dymijë vjetëve më parë, njerëzit e kohës sonë, ndoshta jo gjithnjë në mënyrë të vetëdijshme, u kërkojnë besimtarëve të sotëm jo vetëm t’u “flasim” për Krishtin, por në një farë mënyre t’ua bëjnë atyre të “dukshëm”. A mos nuk është detyrë e kishës të reflektojë dritën e Krishtit në çdo epokë të historisë, të bëjë që të shkëlqejë fytyra e tij edhe përpara brezave të mijëvjeçarit të ri?

Dëshmia jonë do të ishte, gjithësesi, tepër fort e varfër, nëse ne më së pari nuk do të ishim *soditës të fytyrës së tij*. Jubileu i Madh sigurisht na ka ndihmuar për të qenë të tillë në mënyrë më të thellë. Në përfundim të Jubileut, ndërsa rimarrim ecjen e zakonshme, duke mbartur në shpirt pasurinë e përvojave të jetuara në këtë periudhë kaq të posaçme, vështrimi mbetet më shumë se kurrë *i ngulitur mbi fytyrën e Zotit*.

### *Dëshmia e Ungjijve*

17. Dhe soditja e fytyrës së Krishtit nuk mund të frymëzohet veçse nga çka për Të na flet Shkrimi i Shenjtë, që është, nga kreu në fund, i përshkuar nga misteri i tij, i treguar në mënyrë të errët në Besëlidhjen e Vjetër, plotësisht i zbuluar në të Renë, aq sa shën Jeronimi vendos me forcë: “Mosnjohja e Shkrimeve është mosnjohje e vetë Krishtit”.<sup>8</sup> Duke mbetur të ankoruar tek Shkrimi, i hapemi veprimin të Shpirtit (krh Gjn 15,26), që është në zanafillë të këtyre shkrimeve dhe së bashku me *dëshminë e Apostujve* (krh po aty, 27), që kanë bërë përvojën e gjallë të Krishtit, Fjala e jetës, e kanë parë me sytë e tyre, dëgjuar me veshët e tyre, prekur me duart e tyre (krh 1 Gjn 1,1).

Ajo që na arrin për mes tyre është një pamje feje, e mbështetur nga një dëshmi e saktë historike: një dëshmi vërtetësore, që Ungjijtë, megjithë redaktimin e tyre kompleks dhe me një synim më së pari kateketik, na dorëzojnë në mënyrë të tillë që mund t’u zihet besë plotësisht.<sup>9</sup>

18. Ungjijtë në realitet nuk pretendojnë të jenë një biografi e plotë e Jezusit sipas kritereve të shkencës moderne historike. Prej tyre gjithësesi *fytyra e Nazarenit del në pah me një themel të sigurtë historik*, duke qenë se Ungjilltarët u preokupuan për ta përshkuar duke

---

<sup>8</sup> “Ignoratio enim Scripturarum ignoratio Christi est”: Comm. In Is., Prol.: PL 24,17.

<sup>9</sup> Krh Konç Ekum Vat. II, Kusht. Dogm. Mbi zbuluesën hyjnore *Dei Verbum*



mbleddhur dëshmi të besueshme (krh Lk 3,23) dhe duke punuar mbi dokumente të nënshtruar shqyrtimit vigjilent kishtar. Qe mbi bazën e këtyre dëshmimeve të orës së parë që ata, nën veprimin ndriçues të Shpirtit Shenjt, mësuan të dhënë njerëzisht shtanguese të lindjes virgjërore të Jezusit nga Maria, nuse e Jozefit. Prej atyre që e kishin njohur gjatë tridhjetë vjetëve prej tij të kaluar në Nazaret (krh Lk 3,23) mblodhën të dhënat mbi jetën e tij si “bir i marangozit” (Mt 13,55) dhe marangoz ai vetë, mirë i vendosur në suazën e farefisit të tij (krh Mc 6,3). Regjistruan religjiozitetin e tij, që e shtynte të shkonte me të tijtë në shtegtimin e përvitshëm në tempullin e Jeruzalemit (krh Lk 2,41) dhe sidomos e bënte frekuentues të zakonshëm të sinagogës së qytetit të vet (krh Lk 4,16).

Njoftimet bëhen pastaj më të gjera, edhe pse pa qenë një tregim organik e i detajuar, për periudhën e shërbesës publike, nisur nga momenti në të cilin Galileasi i ri shkon të pagëzohet nga Gjon Pagëzuesi në Jordan, dhe i fortë në dëshminë prej së larti, me vetëdijen e të qenit “djali i dishirit” (Lk 3,22), fillon predikimin e tij të ardhjes së Mbretërisë së Hyjit, duke dhënë shembuj për çka ajo kërkon dhe për fuqinë e saj përmes fjalësh e shenjash të hirit e të mëshirës. Ungjijtë na e paraqesin kështu në ecje nëpër qytete e fshatra, të shoqëruar nga dymbëdhjetë Apostuj të zgjedhur prej tij (krh Mk 3,13-19), prej një grupi grash që i ndihmojnë (krh Lk 8,2-3), prej turmash që e kërkojnë dhe e ndjekin, prej të sëmuresh që i

thërrasin fuqisë së tij shëruese, prej bashkëbiseduesish që ia dëgjojnë me përfitim të ndryshëm, fjalët.

Rrëfimi i Ungjijve përputhet pastaj në të treguarit e tensionit në rritje që krijohet midis Jezusit dhe grupeve spikatëse të shoqërisë religjioze të kohës së tij, deri në krizën përfundimtare, që e ka epilogun e saj dramatik mbi Gologotë. Është ora e territ, të cilën e ndjek një agim i ri rrezatues përfundimtar. Tregimet ungjillore përmbullen në fakt duke e dëftuar Nazarenin fitimtar mbi vdekjen, tregojnë varrin e zbrazët dhe e ndjekin në ciklin e shfaqjeve, në të cilat, nxënësit, më parë të pavendosur e të shtangur, pastaj plot me gëzim të pashprehshëm, e përjetojnë të gjallë dhe rrezatues dhe prej tij marrin dhuratën e Shpirtit (krh Gjn 20,22) dhe urdhrin për t'ua shpallur Ungjillin “të gjithë popujve” (Mt 28,19).

### ***Udha e fesë***

19. “Nxënësit u gëzuan kur e panë Zotërinë” (Gjn 20,20). Fytyra që apostujt kundruan pas ringjalljes ishte e njëjta e atij Jezusi me të cilin kishin jetuar rreth tre vjet dhe që tani i bindte për të vërtetën tronditëse të jetës së tij të re duke u treguar atyre “duart dhe kraharorin” (po aty). Sigurisht, nuk qe e lehtë të besonin. Dishepujt e Emmausit besuan vetëm pas një itinerari të lodhshëm të shpirtit (krh Lk 24,13-35). Apostulli Tomë besoi vetëm pasi e kishte konstatuar mrekullinë (krh Gjn 20,24-29). Në realitet, sado që të prekej e të shihej trupi i tij, *vetëm feja mund ta kapërcente plotësisht misterin e asaj fytyre*. Ishte kjo, një përvojë që dishepujt duhej ta kishin bërë që

me jetën historike të Krishtit, në pyetjet që ceknin mendjet e tyre sa herë që ndiheshin të ngacmuar nga gjestet e tij dhe nga fjalët e tij. Tek Jezusi nuk arrihet vërtet përveçse përmes udhës së fesë, përmes një ecjeje për të cilën Ungjilli vetë duket se na përvijon etapat në skenën e njohur mirë të Cezaresë së Filipit (krh Mt 16,13-20). Dishepujt, gati duke bërë një farë bilanci të parë të misionit të tij, Jezusi i pyet se çfarë “njerëzit” mendojnë për të, duke marrë si përgjigje të kësaj: “Disa Gjon Pagëzori, të tjerë Elia, të tjerë Jeremia ose njeri prej profetëve” (Mt 16,14). Përgjigje sigurisht e ngritur, por e largët ende – dhe sa! – nga e vërteta. Populli arrin të shquajë përmasën fetare dukshmërisht të jashtëzakonshme të këtij *rabbi* që flet në mënyrë aq magjepsëse, por nuk arrin ta vendosë përtej atyre njerëzve të Hyjit që kanë shënuar etapat e historisë së Izraelit. Jezusi, në të vërtetë, është krejt tjetër! Është pikërisht ky hap i mëtejshëm i njohjes, që ka të bëjë me nivelin e thellë të personit të tij, gjëja qw Ai pret edhe prej të “vetëve”: “Ju,... ç’thoni: kush jam unë?” (Mt 16,15). Vetëm feja e shpallur nga Pjetri, dhe me të nga Kisha e të gjithë kohëve, shkon në zemër, duke arritur thellësinë e misterit: “Ti je Krishti, biri i Hyjit të gjallë” (Mt 16,16).

20. Si kishte arritur Pjetri te ky besim? Dhe çfarë na kërkohet neve, nëse duam të vihem në mënyrë gjithnjë e më të bindur mbi gjurmët e tij? Mateu na jep një shënim ndriçues në fjalët me të cilat me të cilat Jezusi pranon dëshmimin e Pjetrit: “nuk ta zbuloi mishi e gjaku, por Ati

im që është në qiell” (16,17). Shprehja “mish e gjak” evokon njeriun dhe mënyrën e zakonshme për të njohur. Kjo mënyrë e zakonshme, në rastin e Jezusit, nuk mjafton. Është i nevojshëm hiri i “zbulësës” që vjen nga Ati (krh *po aty*). Luka na ofron një shenjë që tregon të njëjtin kah, kur thekson se ky dialog me dishepujt u zhvillua “ndërsa [Jezusi] një ditë po lutej në vetmi” (Lk 9,18). Që të dyja shënimet bashkohen në të na bërit të ndërgjegjshëm për faktin se në kundrimin e plotë të fytyrës së Zotit nuk arrijmë vetëm me forcat tona, por duke u lënë të merremi për dore nga hiri. Vetëm *përvoja e heshtjes dhe e lutjes* ofron horizontin e përshtatshëm në të cilin mund të piqet e të zhvillohet njohja më e vërtetë, e përputhur dhe koherente me atë mister, që e ka shprehjen e vet kulmore në shpalljen solemne të ungjilltarit Gjon: “E Fjala u bë njeri e banoi ndër ne; ne e pamë lavdinë e tij, atë lavdi që prej Atit i përket Birit të vetëm plot hir e të vërtetë” (Gjn 1,14).

### ***Thellësia e misterit***

21. Fjala dhe mishi, lavdia hyjnore dhe tenda e tij midis njerëzve! Është në bashkimin intim dhe të pandashëm të këtyre dy polariteteve që qëndron identiteti i Krishtit, sipas formulimit klasik të Koncilit të Kalcedonisë (a. 451): “një person në dy natyra”. Personi është ai dhe vetëm ai i Fjalës së amshuar, bir i Atit. Të

dyja natyrat, pa asnjë ngatërrim por edhe pa asnjë ndarje të mundshme, janë ajo hyjnore dhe ajo njerëzore.<sup>10</sup>

Jemi të vetëdijshëm për kufizimet e koncepteve tona dhe të fjalëve tona. Formula, edhe pse gjithnjë njerëzore, është gjithësesi e kalibruar me vëmendje në përmbajtjen e vet doktrimore dhe na lejon të jepemi, në një farë mënyre, mbi humbëtirën e misterit. Po, Jezusi është Hyj i vërtetë dhe njeri i vërtetë! Si apostulli Tomë, Kisha është vazhdimisht e ftuar nga Krishti për të prekur plagët e tij, për të njohur pra në to njerëzinë e plotë të pranuar nga Maria, të dorëzuar tek vdekja, të shndërruar nga ringjallja: “Shtjere gishtin tënd këtu e qe, shihi duart e mia! Ma jep dorën tënde e shtjere në kraharorin tim” (Gjn 20,27). Ashtu si Toma Kisha përkulet adhuruese përpara të Ringjallurit, në plotësinë e shkëlqimit të tij hyjnor, dhe pambarim gërthet: “Zoti im e Hyji im!” (Gjn 20,28).

22. “Fjala u bë njeri” (Gjn 1,14). Kjo paraqitje e rrufeshme gjoniane e misterit të Krishtit pohohet nga e gjithë Besëlidhja e Re. Në këtë linjë vendoset edhe apostulli Pal kur thotë se Biri i Hyjit “është, për kah trupi,

---

<sup>10</sup> “Duke ndjekur Etërit e shenjtë, njëzëri, ne ju mësojmë të shpallet një i vetmi dhe i njëjti Bir, Zoti ynë Jezu Krishti, i përsosur në hyjninë e tij dhe i përsosur në njerëzinë e tij, Hyj i vërtetë dhe njeri i vërtetë [...] një dhe i njëjti Krisht Zot i njëlindur, për t’u njohur në dy natyra, pa ngatërrim, të pandryshueshme, të papjesëtueshme dhe të pandashme [...] ai nuk është i pjesëtuar ose i ndarë në dy persona, por është një i vetëm dhe i njëjtë bir, i njëlindur, Hyj, Fjalë dhe Zot Jezu Krisht”: DS 301-302.

pasardhës i Davidit” (Rm 1,3; krh 9,5). Nëse sot, me racionalizmin që gjarpëron në një pjesë të madhe të kulturës bashkëkohore, është sidomos feja në hyjninë e Krishtit ajo që përbën problem, ndërsa në të tjera kontekste historike e kulturore pati qenë më fort prirja për ta zvogëluar ose kundërshtuar konkretësinë historike të njerëzisë së Jezusit. Por për fenë e Kishës është thelbësore dhe e paheqshmedore të pohohet se vërtet Fjala “u bë njeri” dhe *ka marrë të gjitha përmasat e njerëzores*, përveç mëkatit (krh Heb 4,15). Në këtë perspektivë, Mishërimi është vërtet një *kenosi*, një “zhveshje”, nga ana e Birit të Hyjit të asaj lavdie që ai ka prej amshimit (krh Fil 2,6-8; 1 Pt 3,18).

Nga ana tjetër, kjo ulje e Birit të Hyjit nuk është qëllim në vetvete; Prirret më fort për nga lavdërimi i plotë i Krishtit, edhe në njerëzinë e tij: “Prandaj edhe Hyji e lartësoi tejet dhe i dha emrin që është mbi çdo emër, që në emër të Jezusit *të përkulet çdo gju*, i atyre që janë në qiell, në tokë e në nëntokë dhe *çdo gjuhë të dëshmojë*: ‘Jezu Krishti është Zot!’- Në nder të Hyjit Atë” (Fil 2,9-11).

23. “Fytyrën tënde, o Zot, do ta kërkoj” (Ps 27 [26]). Dëshira e lashtë e Psalmistit nuk mund të merrte përmbushje më të plotë dhe befasuese se në soditjen e fytyrës së Krishtit. Në të, me të vërtetë Hyji na ka bekuar, dhe ka bërë “të shkëlqejë fytyra e tij” mbi ne (krh Ps 67[66], 3). Në të njëjtën kohë, Hyj e njeri siç është, ai

na zbulon edhe fytyrën reale të njeriut, “ia zbulon plotësisht njeriun njeriut”.<sup>11</sup>

Jezusi është “njeriu i ri” (Ef 4,24; krh Kol 3,10) që thërret për të marrë pjesë në jetën e tij hyjnore njerëzimin e shëlbuar. Në misterin e Mishërimit janë të vendosura bazat për një antropologji që mund të shkojë përtej kufijve të vet dhe kundërthënieve të veta, duke u lëvizur drejt Hyjit vetë, madje, drejt pikëmbërritjes së “hyjnzimit”, përmes shartimit në Krishtin të njeriut të shëlbuar, të pranuar në intimitetin e jetës trinitare. Mbi këtë përmasë shpëtimprurëse të misterit të Mishërimit Etërit kanë ngulmuar shumë: vetëm sepse Biri i Hyjit është bërë me të vërtetë njeri, njeriu mundet, në të dhe përmes tij, të bëhet realisht bir i Hyjit.<sup>12</sup>

### ***Fytyrë e Birit***

24. Ky identitet hyjnor-njerëzor del në pah me forcë nga Ungjijtë, që na ofrojnë një seri elementesh falë të cilëve mund të futemi në atë “zonë-kufi” të misterit, të përfaqësuar nga *vetndërgjegjja e Krishtit*. Kisha nuk dyshon që në tregimin e tyre Ungjilltarët, të frymëzuar prej së Larti, të kenë marrë vesh drejt, në fjalët e shqiptuara nga Jezusi, të vërtetën e personit të tij dhe të

---

<sup>11</sup> Konç Ekum. Vat II, Kusht. Bar. Mbi Kishën në botën bashkëkohore *Gaudium et spes*, 22.

<sup>12</sup> Vëren lidhur me këtë shën Atanazi: “Njeriu nuk mund të hyjnzohet duke mbetur i bashkuar me një krijesë, po të mos ishte Biri Hyj i vërtetë”, *Fjalim kundër Arianëve* 70: PG 26, 425 B.

ndërgjegjes që ai kishte për këtë. A mos nuk është kjo që do të na thotë Luka, duke mbledhur fjalët e para të Jezusit, sapo dymbëdhjetëvjeçar, në tempullin e Jeruzalemit? Ai shfaqet që atëherë i vetëdijshtëm për të qenët në një marrëdhënie unike me Hyjin, siç është ajo vetjake e “birit”. Nënës, në fakt, e cila e bën të shikojë ankthin me të cilin ajo dhe Jozefi e kanë kërkuar, Jezusi i përgjigjet pa hezitim: “Po pse më kërkuat? A nuk e dinit se më duhet të merrem me punët e Atit tim?” (Lk 2,49). Nuk mrekullon pra që në moshën e pjekurisë, e folura e tij të shprehë qartësisht thellësinë e misterit të tij, siç është me bollëk nënvizuar ai nga Ungjijtë sinoptikë (krh Mt 11,27; Lk 10,22), ashtu dhe sidomos nga ungjilltari Gjon. Në vetndërgjegjen e tij Jezusi nuk ka asnjë dyshim: “Ati është në mua dhe unë në Atin” (Gjn 10,38).

Sado që të jetë e ligjshme të mbahet se, për gjendjen njerëzore që e bënte të rritej “në dije, në moshë e në hir” (Lk 2,52) edhe ndërgjegjja njerëzore e misterit të tij do të përparonte deri në shprehjen e plotë të njerëzisë së tij të lavdëruar, nuk ka dyshim se që në ekzistencën e tij historike e kishte vetëdijen e identitetit të tij si Bir i Hyjit. Gjoni e nënvizon derisa pohon se qe, si përfundim, për këtë që u refuzua dhe u dënua: kërkonin në fakt ta vrisnin “jo vetëm se e prishte të shtunën, por edhe Hyjin e quante Atë të vetin, duke e barazuar veten me Hyjin” (Gjn 5,18). Në skenarin e Gjetsemanit dhe të Golgotës, ndërgjegjja njerëzore e Jezusit do t’i nënshtrohet provës më të rëndë. Por as drama e mundimit dhe vdekjes nuk do të arrijë të çënojë sigurinë e tij të qetë të të qenit Bir i Atit qiellor.



### *Fytyrë dhimbjeje*

25. Soditja e fytyrës së Krishtit na çon kështu t'i afrohem aspektit më paradoksal të misterit të tij, i cili del në pah në orën më ekstreme, në orën e Kryqit. Mister në mister, përpara të cilit qenia njerëzore nuk mundet veçse të përkulet në adhurim.

Kalon para vështrimit tonë intensiteti i skenës së agonisë në kopshtin e Ullinjve. Jezusi, i shtypur nga parashikimi i provës që e pret, i vetëm përpara Hyjit, e thërret me shprehjen e tij të zakonshme e të butë të mirëbesimit: “Abba, Atë”. I kërkon ta largojë prej tij, nëse është e mundur, kelkun e vuajtjes (krh Mk 14,36). Por Ati duket se nuk do ta dëgjojë zërin e Birit. Për t'i risjellë njeriut fytyrën e Atit, Jezusit i është dashur jo vetëm të marrë fytyrën e njeriut, por të ngarkohet deri edhe me “fytyrën” e mëkatit. “Atë që kurrë nuk bëri mëkat, Hyji për ne e bëri mëkat, në mënyrë që në të ne të bëhemi drejtësi e Hyjit” (2 Kor 5,21).

Nuk do të mbarojmë kurrë së hulumtuari thellësisë së këtij misteri. Është gjithë ashpërsia e këtij paradoksi që zbulohet në britmën e dhimbjes, në dukje të dëshpëruar, që Jezusi ngre mbi kryq: “*Eloi, Eloi, lemà sabactàni?*”, që do të thotë: Hyji im, Hyji im, përse më ke braktisur?” (Mk 15,34). A është e mundur të imagjinohet një shëmtim më i madh, një errësi më e dendur? Në realitet, “përse-ja” angështuese drejtuar Atit me fjalët nisëtoje të Psalmi 22, edhe duke ruajtur krejt realizmin e një dhimbjeje të pashprehshme, ndriçohet nga kuptimi i lutjes së tërë, në të cilën Psalmisti bashkon, një një

gërshetim prekës ndjenjash, vuajtjen dhe mirëbesimin. Vazhdon në fakt Psalmi: “Në ty shpresuan etërit tanë, shpresuan e ti i shpëtove [...] Mos qëndro larg meje, sepse rreziku është afër e s’kam tjetërkënd që të më ndihmojë” 22[21],5.12).

26. Klithma e Jezusit mbi kryq, shumë të dashur Vëllezër e Motra, nuk tradhton ankthin e një të dëshpëruari, por lutjen e Birit që ofron jetën e vet Atit në dashuri, për shpëtimin e të gjithëve. Ndërsa identifikohet me mëkatin tonë, “i braktisur” nga Ati, ai “braktiset” në duart e Atit. Sytë e tij mbeten të ngulitur mbi Atin. Pikërisht për njohjen dhe përvojën e Hyjit që vetëm ai ka, edhe në këtë moment errësimi ai sheh kthjelltësisht peshën e mëkatisht dhe vuan për të. Vetëm ai, që sheh Atin dhe i gëzohet plotësisht, mat deri në fund se çfarë do të thotë t’i rezistosh me mëkatin dashurisë së tij. Ende më parë, dhe shumë më tepër se në trup, mundimi i tij është vuajtje mizore e shpirtit. Tradita teologjike nuk i është shmangur pyetjes se si mundej Jezusi të jetonte njëkohësisht bashkimin e thellë me Atin, për nga natyra e tij burim gëzimi e lumturie, dhe agoninë deri në klithmën e braktisjes. Bashkëprania e këtyre dy përmasave në dukje të papajtueshme është në realitet e rrenjosur në thellësinë e padepërtueshme të bashkimit ipostatik (*të dy natyrave – shën. i përkthyesit*).

27. Përballë këtij misteri, krahas hulumtimit teologjik, një ndihmë e rëndësishme mund të na vijë nga ajo trashëgimi e madhe që është “teologjia e jetuar” e

Shenjtërve. Ata na ofrojnë udhëzime të çmuara që lejojnë të pranohet më lehtësisht intuïta e fesë, dhe kjo në forcë të dritave të veçanta që disa prej tyre kanë marrë nga Shpirti Shenjt, o madje deri përmes përvojës që ata vetë kanë bërë të atyre gjendjeve të tmerrshme të provës që tradita mistike përshkruan si “natë e errët”. Jo rrallëherë Shenjtërit kanë jetuar *diçka të ngjashme me përvojën e Jezusit mbi kryq* në gërshetimin paradoksal të lumturisë dhe dhimbjes. Në *Dialog i Provanisë Hyjnore* Hyji Atë i tregon Katerinës nga Siena se si në shpirtërat e shenjtë mund të jetë i pranishëm gëzimi së bashku me vuajtjen: “Dhe shpirti mbetet i lumtur dhe në dhimbje: në dhimbje për mëkatet e të afërmit, i lumtur për bashkimin, e për prekjen e dashurisë që ka marrë në vetvete. Këta imitojnë qingjin e panjollë, të Njëlindurin Birin tim, i cili duke qëndruar mbi kryq ishte i lumtur e në dhimbje”.<sup>13</sup> Në të njëjtën mënyrë Tereza e Lizië jeton agoninë e saj në bashkim me atë të Jezusit, duke verifikur në veten e vet pikërisht paradoksin e Jezusit të lumtur dhe në ankth: “Zoti ynë në kopshtin e Ullinjve shijonte të gjitha gëzimet e Trinisë, e pra agonia e tij nuk ishte më pak mizore. Është një mister, por ju siguroj se prej nga ç’provoj unë vetë kuptoj diçka për këtë”.<sup>14</sup> Është një dëshmi ndriçuese! Fundja, vetë rrëfimi i Ungjilltarëve i jep themelin këtij perceptimi kishtar të ndërjegjes së Krishtit, kur kujton se, edhe pse në humbëtirën e tij të

---

<sup>13</sup> N. 78.

<sup>14</sup> Biseda të fundit, Fletorja e verdhë, 6 korrik 1897: Vepra të plota, Citta del Vaticano 1997, 1003

dhimbjes, ai vdes duke lypur falje për xhelatët e tij (krh Lk 23,34) dhe duke i shprehur Atit braktisjen e tij të skajshme birnore: “O Atë, në duart e tua po e dorëztoj shpirtin tim” (Lk 23,46).

### ***Fytyrë e të Ringjallurit***

28. Ashtu si në të premtën dhe në të Shtunën e Madhe, Kisha vazhdon të mbetet në kundrim të kësaj fytyrë të përgjakur, në të cilën fshihet jeta e Hyjit dhe ofrohet shpëtimi i botës. Por kundrimi i saj i fytyrës së Krishtit nuk mund të ndalet tek imazhi i atij të kryqëzuar. *Ai është i Ringjalluri!* Nëse nuk do të ishte kështu, i kotë do të ishte predikimi ynë e kotë feja jonë (krh 1 Kor 15,14). Ringjallja që përgjigjja e Atit ndaj bindjes së tij, siç kujton letra drejtuar Hebrejve: “Ai, në ditët e jetës së vet këtu mbi tokë i kushtoi urata dhe lutje me ofshame të mëdha dhe me lot atij që mund ta shpëtonte nga vdekja, dhe që vështruar për shkak të nënshtrimit të vet. Ai, megjithëse ishte Bir, mësoi nga ato që pësoi të jetë i dëgjueshëm dhe, pasi e fitoi përsosmërinë, për të gjithë ata që e dëgjojnë, u bë shkak i shëlbimit të amshuar” (5, 7-9).

Është drejt Krishtit të Ringjallur që Kisha sheh tashmë. E bën duke u vendosur mbi gjurmët e Pjetrit, që derdhi lotë për mohimin e tij, dhe e rimori ecjen e tij duke i rrëfyer Krishtit, me drithërimë, dashurinë e tij: “Ti e di se unë të dua” (Gjn 21,15.17). E bën duke u vënë në shoqërinë e Palit, që e takoi në rrugën drejt Damaskut dhe

mbeti i flakëruar: “Vërtet për mua Krishti është jetë dhe vdekja fitesë” (Fil 1,21).

Në dymijë vjet largësi prej këtyre ngjarjeve, Kisha i rijeton sikur të kishin ndodhur sot. Në fytyrën e Krishtit ajo, Nusja, kundron thesarin e saj, gëzimin e saj. “*Dulcis Jesu memoria, dans vera cordis gaudia*”: sa është i ëmbël kujtimi i Jezusit, burim gëzimi të vërtetë të zemrës! E ngushëlluar nga kjo përvojë, Kisha rimerr sot ecjen e saj, për t’i lajmëruar Krishtin botës në fillim të mijëvjeçarit të tretë: Ai “është i njëjti dje, sot e gjithmonë” (Heb 13,8).

### III TË RINISEMI NGA KRISHTI

29. “Dhe ja, unë jam më ju gjithmonë, deri në të sosur të botës” (Mt 28,20). Kjo siguri, shumë të dashur Vëllezër e Motra, e ka shoqëruar Kishën për dy mijëvjeçarë dhe ka qenë tani e rigjallëruar në zemrat tona nga kremtimi i Jubileut. Prej saj duhet të nxjerrim *një hov të përtërirë në jetë e krishterë*, duke e bërë atë madje forcën frymëzuese të ecjes sonë. Është në vetëdijen e kësaj pranie midis nesh të të Ringjallurit që ia bëjmë vetes sot pyetjen drejtuar Pjetrit në Jerusalem, menjëherë pas fjalimit të tij të Rrëshajëve: “Çfarë duhet të bëjmë?” (Vap 2,37).

Pyetemi me optimizëm besimplotë, gjithë pa i nënvleftësuar problemet. Nuk na josh sigurisht perspektiva naive se, përballë sfidave të mëdha të kohës

sonë, të mund të ketë një formulë magjike. Jo, nuk do të na shpëtojë një formulë, por një Person, dhe siguria që ai na shtie: *Unë jam me ju!*

Nuk bëhet fjalë atëherë, për të shpikur një “program të ri”. Programi është tashmë: është ai i gjithmonshmi, i mbledhur nga Ungjilli dhe nga Tradita e gjallë. Ai qendërohet, në analizë të fundit, në Krishtin vetë, për t’u njohur, dashur, imituar, për të jetuar me të jetën trinitare, dhe për të shndërruar me të historinë deri në plotësimin e saj në Jerusalemin qiellor. Është një program që nuk ndryshon me ndryshimin e kohëve dhe të kulturave, edhe pse kohën dhe kulturën e merr parasysh për një dialog të vërtetë dhe një komunikim efikas. Ky program që ka qenë gjithmonë është i yni për mijëvjeçarin e tretë.

Është e nevojshme gjithësesi që ai të përkthehet në *orientime baritore të përshtatshme me kushtet e cilësdo bashkësi*. Jubileu na ka ofruar mundësinë e jashtëzakonshme që të angazhohemi, për disa vjet, në një ecje të njësuar të të gjithë Kishës, një ecje katekistike të hartuar mbi temën trinitare dhe të shoqëruar nga impenjime të dallueshme baritore që të synojnë tek një përvojë jubilarë pjellore. Falenderoj për gatishmërinë e përzemërt me të cilën u përqaftua gjerësisht propozimi prej meje i bërë në Letër apostolike *Tertio millennio adveniente*. Tani nuk është më një pikëmbërritje që përvijohet fill para nesh, por një horizont i madh dhe impenjues i baritores së zakonshme. Brenda koordinatave universale dhe të paheqshmedore, është e nevojshme që programi i vetëm i ungjillit të vazhdojë të kullojë, siç

ndodh që prej gjithmonë, në historinë e secilit realitet kishtar. Është në *Kishat lokale* që mund të vendosen ato tipare programatike konkrete – objektiva e metoda pune, formim e vlerësim i operatorëve, kërkim i mjeteve të nevojshme – që i lejojnë lajmit të Krishtit të arrijë personat, të plazmojë bashkësitë, të çelë vrugë në thellësi përmes dëshmisë së vlerave ungjillore në shoqëri e në kulturë.

Nxis, prandaj, gjallërisht Barinj të e Kishave të veçanta, të ndihmuar nga pjesëmarrja e përbërsve të ndryshëm të Popullit të Hyjit, për të përcaktuar me besim etapat e ecjes së re, duke sintonizuar zgjedhjet e secilës Bashkësi dioqezane me ato të kishave fqinje e me ato të Kishës së gjithëmbarshme.

Një sintoni e tillë do të jetë e lehtësuar sigurisht nga puna kolegjiale, tashmë e bërë e zakonshme, që kryhet nga Ipeshkvijtë në Konferencat ipeshkvnore dhe në Sinodet. A mos nuk ka qenë ky edhe kuptimi i Asambleve kontinentale të Sinodit të Ipeshkvijve, që kanë ritmuar përgatitjen e Jubileut, duke përpunuar linja domethënëse për lajmërimin e Ungjillit sot në kontekstet e shumëfishta dhe në kulturat e ndryshme? Kjo trashëgimi e pasur reflektimi nuk duhet të lihet të bjerë, por të bëhet vepruese në mënyrë konkrete.

Është pra një vepër entuziazmuere rinisjeje baritore që na pret. Një vepër që na përfshin të gjithë. Dëshiroj gjithësesi të vë në dukje, për ndërtimin dhe orientimin e përbashkët, disa *çështje baritore të dorës së parë*, që vetë

përvoja e Jubileut të madh ka bërë të dalin në pah me forcë të veçantë para vështrimit tim.

### *Shenjtëria*

30. Dhe në radhë të parë nuk hezitoj të them se perspektiva në të cilën duhet të vendoset e gjithë ecja baritore është ajo e *shenjtërisë*. A nuk ishte ndoshta ky kuptimi i fundmë i ndjesës jubilarë, si hir i veçantë i ofruar nga Krishti në mënyrë që jeta e çdo të pagëzuarit të mund të pastrohej dhe përtërihej thellësisht?

Uroj që, midis atyre që kanë marrë pjesë në Jubile, të kenë qenë të shumtë ata që e kanë shijuar këtë hir, me ndërgjegje të plotë të karakterit të tij kërkues. Si ka mbaruar Jubileu, rifillon ecja e zakonshme, por të orientojë për nga shenjtëria, kjo mbetet më shumë se kurrë një urgjencë e baritores.

Nevojitet atëherë të zbulohet, në të gjithë vlerën e saj programatike, kapitulli V i Kushtetutës dogmatike mbi Kishën *Lumen Gentium*, dedikuar “thirrjes së gjithëmbarshme për shenjtëri”. Nëse etërit konçiliarë i vunë kaq theks kësaj tematike, nuk qe për t’i dhënë një lloj penelate shpirtërore ekleziologjisë, por më fort për të bërë të dalë prej saj një dinamikë vetjake dhe cilësuese. Rizbulimi i Kishës si “mister”, apo si “popull i tubuar nga njësia e Atit, e Birit dhe e Shpirtit”,<sup>15</sup> nuk mund të mos

---

<sup>15</sup> S. Cipriani, De Orat. Dom. 23: PL 4, 553; krh *Lumen Gentium*, 4.



sillte me vete edhe rizbulimin e “shenjtërisë” së saj, të marrë me kuptimin themelor të përkatësisë tek Ai që është për antonomasi Shenjti, “tri herë Shenjt” (krh *Is* 6,3). Ta shpallësh Kishën si të shenjtë dotë thotë ta tregosh fytyrën e saj si Nuse e Krishtit, për të cilën ai është dhuruar, pikërisht me qëllimin për ta shenjtëruar (krh *Ef* 5,25-26). Kjo dhuratë shenjtërie, si të thuash, objektive, i është ofruar çdo të pagëzuari.

Por dhurata përkthehet nga ana e vet në një detyrë, që duhet të qeverisë mbarë ekzistencën e krishterë: “Vullneti i Hyjit është ky: shenjtërimi juaj” (1 *Sel* 4,3). Është një angazhim që nuk u kërkohet vetëm disa të krishterëve: “Të gjithë besimtarët e cilësdo gjendjeje ose shkalle janë të thirrur për plotësinë e jetës së krishterë dhe për përsosmërinë e dashurisë”.<sup>16</sup>

31. Të kujtosh këtë të vërtetë elementare, duke e vënë në themel të programimit baritor që na sheh të angazhuar në fillim të mijëvjeçarit të ri, mund të dukej, me të parën, si diçka pak vepruese. A mundet vallë të “programohet” shenjtëria? Çfarë kuptimi mund të ketë kjo fjalë, në logjikën e një plani baritor?

Në realitet, ta vendosësh planin baritor në shenjtërinë e shenjtërisë është një zgjedhje e mbarsur me pasoja. Do të thotë të shprehësh bindjen se, nëse Pagëzimi është një hyrje e vërtetë në shenjtërinë e Hyjit përmes përfshirjes

---

<sup>16</sup> Konç Ekum Vat. II, Kusht dogm mbi Kishën *Lumen Gentium*, 40.

në Krishtin dhe banimit në ne të Shpirtit të tij, do të ishte një kundërthënie kënaqja me një jetë mediokre, të jetuar nën drejtimin e një etike minimalistike dhe të një religjioziteti sipërfaqësor. Të pyesësh një katekumen: “A don të marrësh pagëzimin?” do të thotë në të njëjtën kohë ta pyesësh: “A don të bëhesh i shenjtë?”. Do të thotë të vendosësh në rrugën e tij radikalizmin e fjalimit mbi Mal: “Jini pra të përkryer, siç është i përkryer edhe Ati juaj që është në qiell” (Mt 5,48).

Ashtu si Konçili vetë ka shpjeguar, ky ideal përsosmërie, nuk duhet interpretuar njësoj sikur të nënkuptonte një lloj jete të jashtëzakoshme, të praktikueshme vetëm nga disa “gjenij” të shenjtërisë. Udhët e shenjtërisë janë të shumëfishta, dhe të përshtatshme për thirrjen e secilit. Falënderoj Zotin që më ka dhënë të lumturoj e të kanonizoj, në këto vite, shumë të krishterë, e midis tyre shumë laikë që janë shenjtëruar në kushtet më të zakonshme të jetës. Është koha për t’u ripropozuar të gjithëve me bindje, këtë *“masë të lartë” të jetës së krishterë të zakonshme*: e gjithë jeta e bashkësisë kishtare dhe e familjeve të krishtera duhet të çojë në këtë drejtim. Por është edhe e dukshme se shtigjet e shenjtërisë janë personale, dhe kërkojnë një *pedagogji të shenjtërisë*, të vërtetë e me plot kuptimin e fjalës, që të jetë e aftë për t’u përshtatur me ritmet e personave të veçantë. Ajo do të duhet të integrojë pasuritë e propozimit drejtuar të gjithëve me format tradicionale të ndihmës personale dhe në grup dhe me forma më të

fundme të ofruara në shoqatat e në lëvizjet e njohura nga Kisha.

### ***Lutja***

32. Për këtë pedagogji të shenjtërisë është nevoja e një krishtërimi që të shquhet para së gjithash në *artin e lutjes*. Viti Jubilar ka qenë një vit lutjeje më intensive, personale e në bashkësi. Por e dimë mirë se edhe lutja nuk vjen vetë. Është e nevojshme të mësohet, gati sikur nisim gjithnjë nga e para këtë art të vetë buzëve të Mësuesit hyjnor, ashtu si dishepujt e parë: “Zot, mësona të lutemi!” (Lk 11,1). Në lutje zhvillohet ky dialog me Krishtin që na bën intimë me të: “Banoni në mua ashtu sikurse unë në ju” (Gjn 15,4). Ky reciprocitet është thelbi vetë, shpirti i jetës së krishterë dhe është kusht i çdo jete baritore të përnjëmendte. E realizuar në ne, ajo na hap, përmes Krishtit dhe në Krishtin, ndaj soditjes së fytyrës së Atit. Të mësosh këtë logjikë trinitare të lutjes së krishterë, duke e jetuar plotësisht, para së gjithash në liturgji, kulm e burim i jetës së krishterë,<sup>17</sup> por edhe në përvojën personale, është sekreti i një krishtërimi vërtet jetësor, që nuk ka arsye për t’iu trembur të ardhmes, sepse vazhdimisht kthehet tek burimet dhe në to rilindet.

33. A mos nuk është një “shenjë e kohëve” që të regjistrohet sot, në botë, pavarësisht nga proceset e gjera të shekullarizimit, *një kërkesë e përhapur shpirtërie*, që

---

<sup>17</sup> Krh Konç. Ekum. Vat.II, Kusht. Dogm. Mbi Kishën *Lumen Gentium*, 40

në një pjesë të madhe shprehet pikërisht në *një nevojë të përtërirë lutjeje*? Edhe religjionet e tjera, tashmë gjerësisht të pranishme edhe në vendet e krishterizuara që në lashtësi, i ofrojnë përgjigjet e tyre kësaj nevojë dhe e bëjnë nganjëherë me mënyra joshëse. Ne që kemi hirin të besojmë në Krishtin, shfaqës i Atit dhe Shpëtimtar i botës, kemi detyrën të tregojmë se në ç'thellësi mund të çojë raporti me të.

Tradita e madhe mistike e Kishës, si në Lindje ashtu dhe në Perëndim, mund të thotë shumë lidhur më një çështje të tillë. Ajo tregon sesi lutja mund të përparojë, si një dialog i vërtetë dashurie, deri sa ta bëjë personin njerëzor të jetë tërësisht i pushtuar nga i Dashuri hyjnor, të drithërohet në prekjen e Shpirtit, birësisht i braktisur në zemrën e Atit. Bëhet atëherë përvoja e gjallë e premtimit të Krishtit: “atë që më do mua do ta dojë dhe Ati im dhe unë do ta dua dhe do t’i dëftohem” (Gjn 14,21). Bëhet fjalë për një ecje tërësisht të mbështetur nga hiri, që kërkon gjithësesi angazhim të fortë shpirtëror dhe njëj edhe purifikime të dhimbshme (“nata e errët”), por mbërrin, në forma të mundshme, tek gëzimi i pashprehshëm i jetuar nga mistikët si “bashkim martesor”. Si të harroj këtu, ndër shumë dëshmi të ndritshme, doktrinën e shën Gjonit të Kryqit e të shenjtes Terezë të Avilës?

Po, shumë të dashur Vëllezër e Motra, bashkësitë tona të krishtera duhet të bëhen “*shkolla*” të *përnjëmendta lutjeje*, ku takimi me Krishtin të mos shprehet vetëm në përgjërimit për ndihmë, por edhe në

falënderim, lavdërim, adhurim, soditje, dëgjim, flakë ndjenjash, deri në një “dashurim” të vërtetë të zemrës. Një lutje e qëndrueshme pra, që gjithësesi nuk shmang nga angazhimi në histori: duke i hapur zemrën dashurisë së Hyjit, e hap edhe ndaj dashurisë së vëllezërve, dhe bën të aftë për të ndërtuar historinë sipas planit të Hyjit.<sup>18</sup>

34. Sigurisht, për lutje janë të thirrur në veçanti ata besimtarë që kanë pasur dhuratën e thirrjes për një jetë shugurimi të posaçëm: kjo i bën, për natyrë të vet, më të disponueshëm ndaj përvojës soditëse, dhe është e rëndësishme që ata ta kultivojnë me angazhim bujar. Por do të ishte e gabuar të mendonim se të krishterët e zakonshëm mund të kënaqen me një lutje sipërfaqësore, të paaftë për të mbushur jetën e tyre. Veçanërisht përballë provave të shumta që bota e sotme i vendos fesë, ata do të ishin jo vetëm të krishterë mediokrë, por “të krishterë në rrezik”. Do të ndeshnin në fakt rrezikun që, pa e kuptuar, ta shihnin gjithnjë e më të dobësuar fenë e tyre, e madje do të katandiseshin t’i jepeshin tërheqjes së “surrogateve”, duke pranuar propozime religjioze alternative dhe duke u lëshuar deri para formash ekstravagante të bestytnisë.

Nevojitet atëherë që *edukimi në lutje* të bëhet në një farë mënyre një pikë cilësuese e çdo programimi baritor. Unë vetë jam orientuar për t’ia dedikuar katekezat e ardhshme të së mërkurës *reflektimit mbi Psalmes*, duke

---

<sup>18</sup> Krrh Kongr. Për Doktrinën e Fesë, Letër mbi disa aspekte të meditimit të krishterë Orationis formas (15 tetor 1989): AAS 82 (1990), 362-379.

filluar nga ato të Lavdeve, në të cilat lutja publike e Kishës na fton për t'i kushtuar dhe orientuar ditët tona.

Sa e dobishme do të ishte që jo vetëm në bashkësitë rregulltare, por edhe në ato famullitare, të punohej më shumë në mënyrë që e gjithë klima të ishte e përshtetur nga lutja. Do të nevojitej të vlerësoheshin, me shqyrtimin e duhur, format popullore e sidomos të punohej për edukimin në ato liturgjike. Një ditë e bashkësisë së krishterë, në të cilën lidhen së bashku angazhimet e shumëfishta baritore dhe të dëshmisë në botë me kremtimin eukaristik e, nëse është e mundur, me recitimin e Lavdeve dhe të Mbrëmësore, është ndoshta më e “mendueshme” nga ç’besohet zakonisht. Përvoja e shumë grupeve të angazhuara në mënyrë të krishterë, edhe me një përbërës të fortë laikal, e tregon këtë.

### *Eukaristia e së dielës*

35. Angazhimi më i madh duhet vendosur pra tek liturgjia, “kulmi drejt të cilit priret veprimi i Kishës dhe, njëkohësisht, burimi prej nga gulfon krejt virtyti”.<sup>19</sup> Në shekullin XX, veçanërisht nga Konçili e më pastaj, shumë është rritur bashkësia e krishterë në mënyrën e të kremtuarit të Sakramenteve dhe sidomos të Eukaristisë. Duhet ngulmuar në këtë drejtim, duke nxjerrë në pah veçanërisht *Eukaristinë e së të dielës* dhe vetë të *dielën*, të ndjerë si ditë e veçantë e fesë, ditë e Zotit të Ringjallur

---

<sup>19</sup> Konç. Ekum. Vat. II, Kusht. Dogm. Mbi Kishën *Lumen Gentium*, 40.

dhe e dhuratës së Shpirtit, Pashkë e vërtetë e javës.<sup>20</sup> Prej dymijë vjetësh, koha e krishterë është e ritmuar nga kujtimi i asaj “dite të parë pas të shtunës” (Mk 16, 2,9; Lk 24,1; Gjn 20,1), në të cilën Krishti i ringjallur u solli Apostujve dhuratën e Paqes e të Shpirtit (krh Gjn 20,19-23). E vërteta e ringjalljes së Krishtit është e dhëna fillestare mbi të cilën mbështet feja e krishterë (krh 1 Kor 15,14), ngjarje që vendoset në qendër të misterit të kohës, dhe është shembëllesë e ditës së fundit, kur Krishti do të kthehet i lavdishëm. Nuk dimë se çfarë ngjarjesh do të na rezervojë mijëvjeçari që po fillon, por kemi sigurinë se ai do të mbetet i patundur në duart e Krishtit, “Mbret i mbretërve dhe Zotërues i zotëruesve” (Zb 19,16), e pikërisht duke kremtuar Pashkën e tij, jo vetëm një herë në vit, por çdo të dielë, Kisha do të vazhdojë t’i tregojë çdo breznie “atë që përbën boshtin mbajtës të historisë, për nga i cili risillen misteri i zanafillave dhe ai i fatit përfundimtar të botës”.<sup>21</sup>

36. Do të doja gjithësesi të këmbëngulja, në vazhden e *Dies Domini*, që pjesëmarrja në Eukaristi të jetë vërtet, për çdo të pagëzuar, *zemra e së dielës*: një angazhim prej të cilit nuk mund të hiqet dorë, për t’u jetuar jo vetëm për të zbatuar një urdhëresë, por si nevojë e një jete të krishterë vërtet të vetëdijshme dhe koherente. Jemi duke hyrë në një mijëvjeçar që parashihet i karakterizuar nga një gërshetim i thellë kulturash dhe religjionesh edhe në

---

<sup>20</sup> Krh Gjon Pali II, Let. Ap. *Dies Domini* (31 maj 1998), 19: AAS 90 (1998), 724.

<sup>21</sup> Po aty., 2: l.c., 714.

vendet e krishterizuara së lashti. Në shumë krahina, të krishterët janë, ose janë duke u bërë, një “grigjë e vogël” (Lk 12,32). Kjo i vendos përballë sfidës për të dëshmuar me forcë akoma më të madhe, shpesh në kushte vetmie dhe vështirësie, aspektet specifike të identitetit të vet. Detyra për të marrë pjesë në eukaristi është një prej këtyre. Eukaristia e së dielës, duke mbledhur në mënyrë të përjavshme të krishterët si familje e Hyjit rreth tryezës së Fjalës dhe të Bukës së jetës, është edhe kundërhelmi më i natyrshëm për shpërhapjen. Ajo është vendi i privilegjuar ku bashkimi në mënyrë konstante shpallet e kultivohet. Pikërisht përmes pjesëmarrjes eukaristike, *dita e Zotit* bëhet edhe *dita e Kishës*,<sup>22</sup> që mund të zhvillojë kështu në mënyrë të efektshme rolin e vet si sakrament bashkimi.

### ***Sakramenti i Pajimit***

37. Një guxim të përtërirë baritor dua pastaj të kërkoj në mënyrë që pedagogjia e përditshme e bashkësive të krishtera të dijë të propozojë në mënyrë bindëse dhe të efektshme praktikën e *sakramentit të Pajimit*. Siç ndoshta e kujtoni, në 1984 ndërhyra lidhur me këtë temë me Nxitjen post-sinodale *Reconciliatio et paenitentia*, që mblidhte frytet e reflektimit të një Asambleje të Sinodit të Ipushkuvijve kushtuar kësaj problematike. Ftoja atëherë për të bërë çdo përpjekje për të përballuar krizën e “ndjesisë së mëkatit” që regjistrohesh në kulturën

---

<sup>22</sup> Krh. Po aty., 35:l.c., 734.



bashkëkohore,<sup>23</sup> por më shumë akoma ftoja për të rizbuluar Krishtin si *mysterium pietatis*, ai në të cilin Hyji na dëfton zemrën e tij të dhembshur dhe na ripajton plotësisht me veten. Është kjo fytyrë e Krishtit që duhet bërë të rizbulohet edhe përmes sakramentit të Pendesës, që është për një të krishterë “*rruga e zakonshme* për të marrë faljen dhe shlyerjen e mëkateve të tij të rënda të kryera pas Pagëzimit”.<sup>24</sup> Kur Sinodi i lartpërmendur përballoi problemin, qëndronte nën sytë e të gjithëve kriza e Sakramentit, veçanërisht në disa krahina të botës. Motivet që ishin në origjinë të kësaj nuk janë zhdukur në këtë hark të shkurtër kohe. Por Viti jubilar, që ka qenë veçanërisht i karakterizuar nga risjellja drejt Pendesës sakramentare, na ka ofruar një mesazh inkurajues, që nuk duhet lënë të humbet: nëse shumë, e ndër ta edhe shumë të rinj, janë afruar me fryt tek ky Sakrament, ndoshta është e nevojshme që barinj të armatosen me besim më të madh, krijueshmëri dhe këmbëngulje kur e paraqesin këtë sakrament dhe kur bëjnë të njohur vlerën e tij. Nuk duhet të dorëzohemi, shumë të dashur Vëllezër në meshtari, përballë krizash të përkohshme! Dhuratat e Zotit – dhe Sakramentet janë ndër më të çmuarat – vijnë prej Atij që e njuh mirë zemrën e njeriut dhe që është Zot i historisë.

---

<sup>23</sup> Krh n. 18: AAS 77 (1985), 224.

<sup>24</sup> Po aty., 31: l.c., 734.

### ***Parësia e hirit***

38. Të angazhohemi me besim më të madh në programimin që na pret për një baritore që t'ia japë krejt hapësirën e saj lutjes, personale dhe në bashkësi, do të thotë të respektojmë një parim qenësor të vështrimit të krishterë të jetës: parësinë e hirit. Ka një tundim i cili që gjithmonë i ngre pritë çdo ecjeje shpirtërore dhe vetë veprimet baritor: ai i të menduarit se rezultatet varen nga aftësia jonë për të bërë dhe për të programuar. Sigurisht, Hyji na kërkon një bashkëpunim real me hirin e vet, dhe prandaj na fton për të investuar, në shërbimin tonë për kauzën e Mbretërisë, të gjitha burimet tona të inteligjencës dhe të veprimit. Por mjerë ne nëse harrojmë se “pa Krishtin s’mund të bëjmë asgjë” (krh Gjn 15,5).

Lutja na bën të jetojmë pikërisht në këtë të vërtetë. Ajo na kujton vazhdimisht parësinë e Krishtit dhe, në raport me të, parësinë e jetës shpirtërore dhe të shenjtërisë. Kur ky parim nuk është i respektuar, a është për t’u mrekulluar nëse projektet baritore ndeshin dështime dhe lënë në shpirt një ndjenjë poshtëruese mëkotësie? Të bëjmë atëherë përvojën e dishepujve në episodin ungjillor të peshkimit të mrekullueshëm: “gjithë natën u përpoqëm e nuk zumë asgjë” (Lk 5,5). Është ky momenti i fesë, i lutjes, i dialogut me Hyjin, për t’i hapur zemrën dallgës së hirit dhe për t’i lejuar fjalës së Krishtit të kalojë përmes nesh me të gjithë fuqinë e saj: *Duc in altum!* Qe Pjetri në atë peshkim që i tha fjalët e fesë: “pasi po thua ti, do t’i qes rrjetat” (po aty). Lejojini Pasardhësit të Pjetrit, në këtë fillim mijëvjeçari, ta ftojë të

gjithë Kishën për këtë akt feje që shprehet në një angazhim të ripërtërirë lutjeje.

### ***Dëgjim i Fjalës***

39. Nuk ka dyshim se kjo parësi e shenjtërisë dhe e lutjes nuk është e konceptueshme veçse duke u nisur nga një *dëgjim i fjalës së Hyjit* i ripërtërirë. Që kur Konçili Vatikan II ka nënvizuar rolin e spikatur të fjalës së Hyjit në jetën e Kishës, sigurisht janë bërë hapa të mëdha përpara në dëgjimin me zell dhe në leximin e vëmendshëm të Shkrimit të Shenjtë. Asaj i është siguruar nderi që meriton në lutjen publike të Kishës. Asaj personat dhe bashkësitë i drejtohen tashmë në masë të madhe, dhe ndër vetë laikët janë të shumtë ata që i dedikohen edhe me ndihmën e çmuar të studimeve teologjike e biblike. Sidomos pastaj është vepra e ungjillizimit dhe e katekezës që është duke u rigjallëruar pikërisht në vëmendjen ndaj fjalës së Hyjit. Duhet, shumë të dashur Vëllezër e Motra, të konsolidohet e thellohet kjo linjë, edhe përmes përhapjes në familje të librit të Biblës. Në veçanti është e nevojshme që dëgjimi i Fjalës të bëhet një takim jetësor, në traditën e lashtë e gjithnjë të vlefshme të *Lectio divina*, që bën të kapet në tekstin biblik fjala e gjallë që shtron pyetje për ekzistencën, e orienton, e plazmon.

40. Të ushqehemi me Fjalën, për të qenë “shërbyes të Fjalës” në angazhimin për ungjillizim: kjo është sigurisht një detyrë parësore për Kishën në fillim të mijëvjeçarit të ri. Ka perënduar tashmë, edhe në vendet e ungjillizimit të

lashtë, situata e një “shoqërie të krishterë”, që, megjithëse përmes shumë dobësish që gjithmonë shënojnë njerëzoren, u referohej haptaz vlerave ungjillore. Sot duhet përballuar me guxim një situatë që bëhet gjithnjë më e larmishme dhe angazhuese, në kontekstin e globalizimit dhe të gërshetimit të ri dhe të ndryshueshëm të popujve e kulturave që e karakterizon. Kam përsëritur shumë herë në këto vite thirrjen e *ungjillizimit të ri*. E përsëris tani, sidomos për të treguar se duhet rindezur në ne hovi i zanafillave, duke u lënë të përshkohemi nga zjarri i predikimit apostolik që vijoi pas Rrëshajës. Duhet të rijetojmë në ne ndjenjën e përflakur të Palit, i cili shpërthente: “i mjeri unë nëse nuk e predikoj Ungjillin!” (1 Kor 9,16).

Ky pasion nuk do të mungojë të ngjallë në Kishë një misionaritet të ri që nuk mund t’i besohet një porcioni “specialistësh”, por do të duhet të përfshijë përgjegjësinë e të gjithë anëtarëve të Popullit të Hyjit. Kush ka takuar vërtet Krishtin, nuk mund ta mbajë për vete, duhet ta shpallë. Nevojitet një hov i ri apostolik që të jetë i jetuar si angazhim i përditshëm i bashkësive dhe i grupeve të krishtera. Kjo gjithësesi do të bëhet në respektin e duhur për ecjen gjithnjë të ndryshme të çdo personi dhe në vëmendjen për kulturat e ndryshme në të cilat mesazhi i krishterë duhet të kallet, në mënyrë që vlerat specifike të çdo populli të mos mohohen, por të pastrohen dhe të sillen në plotësinë e tyre.

Krishtërimi i mijëvjeçarit të tretë do të duhet t'i përgjigjet gjithnjë e më mirë kësaj kërkesë për inkulturim. Duke mbetur plotësisht vetvetja, në besnikërinë e plotë ndaj lajmit ungjillor dhe traditës kishtare, ai do të mbartë edhe fytyrën e shumë kulturave dhe të shumë popujve ku është pranuar e rrënjosur. Bukurinë e kësaj fytyre shumëformëshe të Kishës e kemi shijuar veçanërisht në Vitin jubilar. Është ndoshta vetëm një fillim, një ikonë e saposkicuar e së ardhmes që Shpirti i Hyjit na përgatit.

Propozimi i Krishtit u duhet bërë të gjithëve me besim. Do t'u drejtohem të rriturve, familjeve, të rinjve, fëmijëve, pa i fshehur kurrë kërkesat më rrënjësore të mesazhit ungjillor, por duke plotësuar kërkesat e secilit përsa i përket ndjeshmërisë dhe gjuhës së përdorur, sipas shembullit të Palit, i cili pohonte: “Për të gjithë u bëra gjithçka, që të kushtojë sa të kushtojë por ta shpëtoj ndonjërin” (1 Kor 9,22). Ndërsa ju rekomandoj gjithë këto, mendoj në veçanti për baritoren rinore. Pikërisht përsa u përket të rinjve, siç kam kujtuar pak përpara, Jubileu na ka ofruar një dëshmi gatishmërie bujare. Duhet të dimë ta vlerësojmë atë përgjigje ngushëlluese, duke investuar atë entuziazëm si një “talent” të ri (krh Mt 25,15) që Zoti na ka vënë në duar që ta bëjmë të japë fryt.

41. Të na mbështesë dhe orientojë në këtë “misionaritet” besimplotë, sipërmarrës, krijues, shembulli i shkëlqyer i shumë dëshmitarëve të fesë që Jubileu na ka bërë të rievokojmë. Kisha ka gjetur gjithmonë, në

martirët e saj, një farëz jete. *Sanguis martyrum – semen christianorum*.<sup>25</sup> ky ligj i famshëm i formuluar nga Tertuliani, është dëftuar gjithnjë i vërtetë në provën e historisë. A nuk do të jetë kështu edhe për shekullin, për mijëvjeçarin që jemi duke filluar? Ndoshta ishim tepër të mësuar të mendonim për martirë në terma pak të largët, gati sikur të bëhej fjalë për një kategori të së kaluarës, të lidhur sidomos me shekujt e parë të erës së krishterë. Kujtesa jubilarë na ka hapur një skenar befasues, duke na e treguar kohën tonë veçanërisht të pasur në dëshmitarë, që në një mënyrë ose në tjetrën, kanë ditur të jetojnë Ungjillin në situata armiqësie e përndjekjeje, shpesh deri në dhënien e provës më të lartë të gjakut. Në ta Fjala e Hyjit, e mbjellë në truall të mirë, ka sjellë njëqindfishin (krh Mt 13, 8.23). Me shembullin e tyre na kanë dëftuar dhe gati sheshuar rrugën e së ardhmes. Neve nuk na mbetet veçse të vihemi, me hirin e Hyjit, mbi gjurmët e tyre.

#### IV DËSHMITARË TË DASHURISË

42. “Nëse e doni njeri-tjetrin, të gjithë do t’ju njohin se jeni nxënësit e mi.” (Gjn 13,35). Nëse kemi vërtet kundruar fytyrën e Krishtit, shumë të dashur Vëllezër e Motra, programimi ynë baritor nuk mund të mos

---

<sup>25</sup> Tertulliano, *Apol.*, 50,13: PL 1, 534.

frymëzohet tek “urdhërimi i ri” që ai na ka dhënë: “Sikurse unë ju desha ju, doni edhe ju njeri-tjetrin” (Gjn 13,34).

Është fusha tjetër e madhe në të cilën do të duhet të shprehet një angazhim i vendosur programatik, në nivel kishe të gjithëmbarshme dhe kishash të veçanta: *ajo e kungimit (koinonia)* që mishëron e dëfton qenësinë e vetë të misterit të Kishës. Kungimi është fryti dhe dëftimi i asaj dashurie që, duke buruar nga zemra e Atit të Amshuar, derdhet në ne përmes Shpirtit që Jezusi na jep (krh Rm 5,5), për të na bërë të gjithë ne “një zemër të vetme dhe një shpirt të vetëm” (Vap 4,32). Është pikërisht duke realizuar këtë kungim dashurie, që kisha dëftohet si “sakrament”, apo si “shenjë dhe vegël e kungimit të thellë me Hyjin dhe e unitetit të të gjithë llojit njerëzor”.<sup>26</sup>

Fjalët e Zotit, lidhur me këtë, janë tepër të sakta për të mund t’ua reduktuar kuptimet që mbartin. Shumë gjëra, edhe në shekullin e ri, do të jenë të nevojshme për ecjen historike të Kishës; por nëse do të mungojë dashuria (agape), gjithçka do të jetë e kotë. Është vetë apostulli Pal ai që na e kujton në himnin dashurisë: se edhe nëse do të flisnim gjuhët e njerëzve dhe të engjëjve, dhe do të kishim një fe “sa për të zhvendosur malet”, por pastaj të na mungonte dashuria, gjithçka do të ishte “asgjë” (krh 1 Kor 13,2). Dashuria është vërtet “Zemra” e Kishës, siç e kishte kapur mirë shenjtja Tereza e Liseiux,

---

<sup>26</sup> Konç. Ecum. Vat. II, Kusht. Dogm. mbi Kishën *Lumen Gentium*, 1.

që kam dashur ta shpall doktore të Kishës pikërisht si eksperte të *scientia amoris*: “Kuptova se Kisha kishte një zemër dhe kjo Zemër ishte e ndezur prej dashurisë. Kuptova se vetëm Dashuria i bënte të lëviznin gjymtyrët e Kishës [...] Kuptova se Dashuria i përmblydhte të gjitha Thirrjet, se Dashuria ishte gjithçka”.<sup>27</sup>

### ***Një shpirtëri bashkimi***

43. Ta bëjmë Kishën shtëpinë dhe shkollën e bashkimit: ja sfida e madhe që na rri përpara në mijëvjeçarin që fillon, nëse duam t’u jemi besnikë planeve të Hyjit dhe t’u përgjigjemi edhe pritjeve të thella të botës.

Çfarë do të thotë kjo në konkretësi? Edhe këtu fjalimi mund të përkthehej menjëherë në terma veprimi, por do të ishte e gabuar të kënaqim një shtysë të tillë. Para se të programojmë nisma konkrete nevojitet promovuar një shpirtëri e bashkimit, duke e bërë të dalë në pah si parim edukativ në të gjitha vendet ku përtrajtësohet njeriu dhe i krishteri, ku edukohen shërbyesit e altarit, të kushtuarit, veprimtarët baritorë, ku edukohen familjet dhe bashkësitë. Shpirtëria e bashkimit do të thotë para së gjithash vështrim i zemrës i sjellë mbi misterin e Trinisë që banon në ne, dhe drita e së cilës duhet kapur edhe mbi fytyrën e vëllezërve që na rrinë pranë. Shpirtëria e bashkimit do të thotë gjithashtu aftësi për të dëgjuar

---

<sup>27</sup> MsB 3vo, Opere Complete, Citta del Vaticano, 1997, 223.



vëllain ne fe në bashkimin e thellë të Korpit mistik, pra, si “një që më përket”, për të ditur të bashkëndajmë gëzimet e tij dhe vuajtjet e tij, për të kapur në thellësi dëshirat e tij dhe për t’u kujdesur për nevojat e tij, për t’i ofruar një miqësi të vërtetë dhe të thellë. Shpirtëri e bashkimit është gjithashtu aftësi për të parë parasëgjithash çka është pozitive në tjetrin, për ta pranuar dhe vlerësuar si dhuratë të Hyjit: “një “dhuratë për mua”, përveçse për vëllain që e ka marrë drejtpërdrejt. Shpirtëri e bashkimit është më në fund të dish “t’i lësh hapësirë” vëllait, duke mbartur “barrët e njeri-tjetrit” (Gal 6,2) dhe duke shtyrë tej tundimet egoistike që vazhdimisht na ngrenë pritë dhe prodhojnë konkurrencë, karrierizëm, mosbesim, xhelozë. Të mos i krijojmë iluzione vetes: pa këtë ecje shpirtërore, fort pak do të shërbenin instrumentat e jashtëm të bashkimit. Do të bëheshim aparate pa shpirt, maska bashkimi më fort se rrugë të tij të shprehjes dhe të rritjes.

44. Mbi këtë bazë, shekulli i ri do të duhet të na shohë të angazhuar më shumë se kurrë për të vlerësuar dhe zhvilluar ato fusha dhe instrumente që, sipas direktivave të mëdha të Konçilit Vatikan II, shërbejnë për të siguruar dhe garantuar bashkimin. Si të mos mendojmë, para së gjithash, për *ato shërbime specifike ndaj bashkimit* që janë: *shërbesa pjetrine*, dhe, në marrëdhënie të ngushtë me të, *kolegjialiteti ipeshkvor*. Bëhet fjalë për realitete që e kanë bazën e tyre dhe qëndrueshmërinë e tyre në vetë planin e Krishtit mbi

Kishën,<sup>28</sup> por pikërisht për këtë, nevojtare për një verifikim të vazhdueshëm që t'u sigurojë frymëzimin e drejtpërdrejtë ungjillor.

Shumë është bërë nga Konçili Vatikan II e më pas edhe për sa i përket reformës së Kuries romane, organizimit të Sinodeve, funksionimit të Konferencave ipeshkvore. Por sigurisht shumë mbetet për të bërë, për të shprehur më së miri fuqitë e brendshme të këtyre instrumentave të bashkimit, sot veçanërisht të nevojshëm përballë kërkesës për t'iu përgjigjur me gatishmëri dhe efikasitet problemeve që Kisha duhet të përballojë në ndryshimet kaq të shpejta të kohës sonë.

45. Hapësirat e bashkimit duhen kultivuar dhe zgjeruar ditë për ditë, në çdo nivel, në pëlhurën e jetës së çdo Kishe. Bashkimi këtu duhet të shkëlqejë në raportet midis Ipeshkvijve, priftërinjve e diakonëve, midis Barinjve dhe mbarë Popullit të Hyjit, midis klerit e rregulltarëve, midis shoqatave dhe lëvizjeve kishtare. Për këtë qëllim duhen vlerësuar gjithnjë e më mirë organizmat e pjesëmarrjes të parashikuara nga e Drejta kanonike, si Këshillat *presbiteralë* e *baritorë*. Ata, siç është e ditur, nuk frymëzohen nga kriteret e demokracisë parlamentare, sepse veprojnë për rrugë konsultative dhe jo deliberative;<sup>29</sup> e për këtë, gjithësesi, nuk humbasin

---

<sup>28</sup> Krh. Konç. Ekum. Vat.II, Kusht. Dogm. Mbi Kishën *Lumen Gentium*, c.III.

<sup>29</sup> Krh. Kongr. Për Klerin dhe të Tjera, Instr. Interdikasterial mbi disa çështje rreth bashkëpunimit të laikëve në shërbesën e meshtarëve *Ecclesiae de mysterio* (15 gusht 1997): AAS 89 (1997), 852-877,

ndonjë gjë për nga kuptimi dhe rëndësia. Teologjia dhe shpirtëria e bashkimit, në fakt, frymëzojnë një dëgjim të ndërsjellë dhe efikas midis Barinjve dhe besimtarëve, duke i mbajtur, nga njëra anë, të bashkuar *a priori* në gjithçka që është qenësore, dhe duke i shtyrë, nga ana tjetër, të konvergojnë në mënyrë normale edhe në gjërat e diskutueshme drejt zgjedhjesh të peshuara e të bashkëndara.

Nevojitet për këtë qëllim ta bëjmë tonën urtinë e lashtë që, pa sjellë asnjë paragjykim mbi rolin autoritar të Barinjve, dinte t'i inkurajonte për dëgjimin më të gjerë të të gjithë Popullit të Hyjit. Kuptimplote ajo që shën Benedikti i kujton Abatit të manastirit, duke e ftuar që të dëgjojë edhe më të rinjtë: “Shpesh një më të riu Zoti i frymëzon një mendim më të mirë”<sup>30</sup>. Edhe shën Paulini i Nortës nxit: “Të varemi nga goja e të gjithë besimtarëve, sepse në çdo besimtar fryn Shpirti i Hyjit”<sup>31</sup>.

Nëse pra urtësia juridike, duke vendosur rregulla të prera për pjesëmarrjen, dëfton strukturën hierarkike të Kishës dhe largon tundime arbitrariteti dhe pretendime të pajustificuara, shpirtëria e bashkimit i përcjell një shpirt të dhënës institucionale me një dëftues besimi dhe

---

veçanërisht nenin 5: Organizmat e bashkëpunimit në Kishën e veçantë.

<sup>30</sup> Reg. III, 3: “Ideo autem omnes ad consilium vocari diximus, quia saepe iuniori Dominus revelat quod melius est”.

<sup>31</sup> “*De omnium fidelium ore pendeamus, quia i omnem fidelem Spiritus Dei spirat*”: Epist. 23, 36 a Sulpicio Severo: CSEL 29, 193.

hapjeje që plotësisht i përgjigjet dinjitetit dhe përgjegjësisë të çdo anëtari të popullit të Hyjit.

### ***Larmia e thirrjeve***

46. Kjo perspektivë bashkimi është ngushtësisht e lidhur me aftësinë e bashkësisë së krishterë për t'u bërë hapësirë të gjitha dhuratave të Shpirtit. Bashkimi i Kishës nuk është njëtrajtshmëri, por integrim organik i ndryshmërive legjitime. Është realiteti i shumë gjymtyrëve të bashkangjitura në një trup të vetëm, të vetmin Trup të Krishtit (krh 1 Kor 12,12). Prandaj është e nevojshme që Kisha e mijëvjeçarit të tretë t'i nxisë të gjithë të pagëzuarit dhe të krezmuarit për t'u bërë të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë e vet aktive në jetën kishtare. Krahas shërbesës së urdhëruar, shërbesa të tjera, të themeluara ose thjesht të njohura, mund të lulëzojnë në dobi të gjithë bashkësisë, duke e mbështetur në nevojat e saj të shumëfishta: nga katekizmi tek gjallërimi liturgjik, nga edukimi i të rinjve në shprehjet më të larmishme të dashurisë.

Sigurisht një angazhim bujar duhet vendosur – sidomos me lutjen këmbëngulëse drejtuar të zotit të të korrave (krh Mt 9,38) – për *promovimin e thirrjeve në meshtari dhe në ato të kushtimit të posaçëm*. Është ky një problem i një rëndësie të madhe për jetën e Kishës në çdo pjesë të botës. Në disa Vende të ungjillizimit të lashtë, pastaj, ai është bërë madje dramatik për shkak të kontekstit shoqëror të ndryshuar dhe të shterpësimit religjioz të ndikuar nga komunizmi dhe shekullarizmi.

Është e nevojshme dhe urgjente të hidhen bazat për një *baritore të thirrjeve* të gjerë dhe kapilare, që të arrijë famullitë, qendrat edukuese, familjet, duke ngjallur një reflektim më të vëmendshëm mbi vlerat themelore të jetës, që gjejnë sintezën e tyre vendimtare në përgjigjen që secili është i ftuar t'i japë thirrjes së Hyjit, veçanërisht kur kjo kërkon me ngulm dhurimin tërësor të vetvetes dhe të energjive vetjake për çështjen e Mbretërisë.

Në këtë kontekst merr gjithë relievin e saj çdo thirrje tjetër, e rrënjosur përfundimisht në pasurinë e jetës së re të marrë në sakramentin e Pagëzimit. Në veçanti, do të jetë për t'u zbuluar gjithnjë e më mirë thirrja që është vetjake e laikëve, të thirrur si të tillë për të “kërkuar mbretërinë e Hyjit duke trajtuar gjërat kohore dhe duke i renditur sipas Hyjit”<sup>32</sup> dhe edhe për të kryer “detyrat e veta në Kishë dhe në botë [...] me veprimtarinë e tyre për ungjillizimin dhe shenjtërimin e njerëzve”.<sup>33</sup>

Po në këtë linjë, rëndësi të madhe për bashkimin mbart detyra për të promovuar realitetet e ndryshme grupuese, të cilat si në format më tradicionale, si në ato më të reja të lëvizjeve kishtare, vazhdojnë t'i japin Kishës një gjallëri që është dhuratë e Hyjit dhe përbën një “pranverë të Shpirtit” të përnjëmendtë. Nevojitet sigurisht që shoqatat dhe lëvizjet, sa në Kishën e gjithëmbarshme aq edhe në Kishat e veçanta, të veprojnë në sintoninë e plotë kishtare dhe në bindje ndaj direktivave me autoritet

---

<sup>32</sup> Konç. Ekum. Vat. II, Kusht. dogm. mbi Kishën *Lumen Gentium*, 31.

<sup>33</sup> Konç. Ekum. Vat. II, Dekr. Mbi apostulatin e laikëve *Apostolicam actuositatem*, 2.

të Barinjve. Por kthehet edhe për të gjithë, kërkues dhe i prerë, paralajmërimi i Apostullit: “Mos e pengoni Shpirtin Shenjt të veprojë në ju! Profecitë mos i përbuzni; çdo gjë shqyrtoni me kujdes: mbani të mirën” (1 Sel 5,19-21).

47. Një vëmendje e posaçme, pastaj, duhet t'i sigurohet baritores së familjes, aq më shumë e nevojshme në një moment historik si i tanishmi, që është duke regjistruar një krizë të përhapur dhe rrënjësore të këtij institucioni themelor. Në pamjen e krishterë të martesës, marrëdhënia midis një burri dhe një gruaje – marrëdhënie e ndërsjelltë dhe tërësore, e vetme dhe e pazhbëshme – i përgjigjet planit fillestar të Hyjit, duke zbuluar atë që Hyji ka dashur që “nga fillimi” (Mt 19,8). Në martesën, të ngritur në dinjitetin e Sakramentit, është i shprehur pastaj “misteri i madh” i dashurisë dhëndërore të Krishtit për Kishën e tij (krh Ef 5,32).

Mbi këtë pikë, Kisha nuk mund të tërhiqet para presioneve të një farë kulture, edhe pse të përhapur e nganjëherë militante. Nevojitet më fort të bëhet e mundur që, përmes një edukimi ungjillor gjithnjë e më të plotë, familjet e krishtera të ofrojnë një shembull bindës të mundësisë së një martese të jetuar në mënyrë plotësisht të përshtatur me planin e Hyjit dhe me kërkesat e vërteta të personit njerëzor: për atë të bashkëshortëve, e sidomos për atë më të brishtë të bijve. Vetë familjet duhet të jenë gjithnjë e më të vetëdijshme për vëmendjen që u

detyrohen bijve dhe të bëhen subjekte aktive të një pranie kishtare e shoqërore në mbrojtje të të drejtave të tyre.

### ***Angazhimi ekumenik***

48. E çfarë të themi pastaj për urgjencën për të promovuar bashkimin në mjedisin delikat të *angazhimit ekumenik*? Mjerisht, trashgimitë e trishtuara të së kaluarës na ndjekin ende përtej pragut të mijëvjeçarit të ri. Kremtimi jubilar ka regjistruar ndonjë sinjal vërtet profetik dhe prekës, por ende shumë ecje mbetet për të bërë.

Në realitet, duke na bërë të ngulisim vështrimin mbi Krishtin, Jubileu i madh na ka bërë të marrim një ndërgjegje më të gjallë për Kishën si mister bashkimi. “Besoj në një Kishë të vetme”: çka shprehim në shpalljen e fesë, e ka themelin e vet të fundit në Krishtin, në të cilin Kisha nuk është e ndarë (krh 1 Kor, 1,11-13). Përsa Korp i tij, në njësinë e prodhuar nga dhurata e Shpirtit, ajo është e pandashme. Realiteti i ndarjes lind mbi terrenin e historisë, në raportet midis bijve të Kishës, si rrjedhojë e brishtësisë njerëzore në të pranuarit e dhuratës që vazhdimisht rrjedh nga Krishti-Krye në Korpin mistik. Lutja e Jezusit në Çenakull – “*që të gjithë të jenë një, sikurse ti, Atë, që je në mua e unë në ty, ashtu edhe ata të jenë në ne*” (Gjn 17,21) – është njëkohësisht zbulim dhe bëzajtje. Ajo na zbulon njësinë e Krishtit me Atin sikurse vend burues i bashkimit të Kishës dhe dhuratë e përjetshme që në Atë kjo, në mënyrë të mistershme, do të marrë deri në fund të kohërave.. Ky bashkim, që nuk

mungon të realizohet konkretisht në Kishën katolike, pavarësisht nga kufizimet vetjake të njerëzores, vepron edhe në masë të ndryshme në shumë elemente shenjërimi dhe të vërtete që gjenden në brendësi të Kishave dhe Bashkësive kishtarë të tjera; shumë elemente, si dhurata vetjake të Kishës së Krishtit, i shtyjnë pareshtur drejt bashkimit të plotë.<sup>34</sup>

Lutja e Krishtit na kujton se kjo dhuratë ka nevojë për të qenë e pranuar dhe zhvilluar në mënyrë gjithnjë më të thellë. Thirrja “ut unum sint” është njëkohësisht, urdhër që na detyron, forca që na mbështet, qortim i shëndetshëm për plogështitë tona e për ngushtësitë e zemrës. Është mbi lutjen e Jezusit, jo mbi aftësitë tona, që mbahet besimi për të mund të arritur edhe në histori, bashkimin e plotë dhe të dukshëm të të gjithë të krishterëve.

Në këtë perspektivë ecjeje të përtërirë post-jubilare, vështroj me shpresë të madhe për nga *Kishat e Lindjes*, duke uruar që të rinisë plotësisht ai shkëmbim dhuratash që ka pasuruar Kishën e mijëvjeçarit të parë. Kujtimi i kohës në të cilën Kisha merrte frymë me “dy mushkëri” t’i shtyjë të krishterët e Lindjes dhe të Perëndimit për të ecur së bashku, në bashkimin e fesë dhe në respektin e ndryshmërive legjitime, duke u pranuar dhe mbështetur ndërmjet tyre si gjymtyrë të Korpit të vetëm të Krishtit.

---

<sup>34</sup> Krh Konç Ekum. Vat. II, Kusht. bar. mbi Kishën në botën bashkëkohore *Gaudium et spes*,22



Me angazhim të ngjashëm duhet të kultivohet dialogu ekumenik me vëllezërit e motrat e Bashkimit anglikan dhe të Bashkësive kishare të lindura nga Reforma. Përqasja teologjike mbi pika thelbësore të fesë dhe të moralit të krishterë, bashkëpunimi në veprat e dashurisë dhe, sidomos, ekumenizmi i madh i shenjtërisë , me ndihmën e Hyjit nuk do të munden në të ardhmen të mos prodhojnë frytet e tyre. Ndërkohë bëjmë përpara me besim në ecje, duke dëshiruar momentin në të cilin, me të gjithë dishepujt e Krishtit, pa përjashtim, do të mund të këndojmë së bashku me zë të shpalosur: “Oh, sa punë e mirë e gjë e bukur është kur vëllezërit jetojnë së bashku” (Ps 133[132],1).

### ***Të vesh bast mbi dashurinë***

49. Nga bashkimi ndër-kishtar, dashuria hapet për natyrë të vetën ndja shërbimit universal, duke na projektuar në *angazhimin e një dashurie veprimtare dhe konkrete kundrejt çdo qenieje njerëzore*. Është një fushë, kjo, që i cilëson në mënyrë barabar vendimtare jetën e krishterë, stilin kishtar dhe programimin baritor. Shekulli dhe mijëvjeçari që po nisim do të duhet ende të shohin, dhe madje është e urueshme që ta shohin me forcë më të madhe, se në ç’shkallë përkushtimi di të arrijë dashuria kundrejt të varfërve. Nëse jemi rinisur vërtet nga soditja e Krishtit, do të duhet të dimë ta shquajmë sidomos në fytyrën e atyre me të cilët ai vetë ka dashur të identifikohet: “pata uri e më dhatë të ha, pata etje e më dhatë të pi, isha shtegtar e më përbujtët, isha i zhveshur e

më veshët, i sëmurë e erdhët të më shihni, isha në burg e erdhët tek unë” (Mt 25,35-36). Kjo faqe nuk është një ftesë e thjeshtë për dashuri: është në faqe kristologjike, që projekton një brez drite mbi misterin e Krishtit. Mbi këtë faqe, jo më pak se mbi aspektin e ortodoksisë, Kisha mat besnikërinë e saj si Nuse e Krishtit.

Sigurisht nuk duhet harruar se askush nuk mund të jetë i përjashtuar nga dashuria jonë, nga momenti që “me mishërimin e vet Biri i Hyjit është bashkuar në një farë mënyre me çdo njeri”.<sup>35</sup> Por duke qëndruar tek fjalët e padykuptimita të Ungjillit, në personën e të varfërve ka një prani të posaçme, që i imponon Kishës një zgjedhje parapëlqyese për ta. Përmes një zgjedhjeje të tillë, dëshmohet stili i dashurisë së Hyjit, provania e tij, mëshira e tij, dhe në një farë mënyre mbillen akoma në histori ato fara të Mbretërisë së Hyjit që Jezusi vetë hodhi në jetnën e vet tokësore duke u ardhur ndesh të gjithë atyre që ngarendnin tek ai për të gjitha nevojat shpirtërore dhe materiale.

50. Në fakt, janë të shumta, në kohën tonë, nevojat që ftojnë për veprim ndjeshmërinë e krishterë. Bota jonë fillon një mijëvjeçar të ri të ngarkuar prej kontradiktave të një rritjeje ekonomike, kulturore, teknologjike, që u ofron pak fatlumëve mundësi të mëdha, duke lënë miliona e miliona njerëz në rrethinat e progresit në përballje me kushte jetese mjaft nën minimumin e duhur

---

<sup>35</sup> Konç. Ekum. Vat.II. , Kusht. Bar. Mbi Kishën në botën bashkëkohore *Gaudium et Spes*,34.

për dinjitetin njerëzor. Është e mundur që, në kohën tonë, të jetë ende uria? kush mbetet i dënuar nga analfabetizmi? kujt i mungon kujdesi mjekësor më elementar? kush nuk ka një shtëpi në të cilën të strehohet?

Skenari i varfërisë mund të zgjerohet në mënyrë të pakufizuar, nëse u shtojmë të vjetrave varfëritë e reja, që përfshijnë shpesh edhe mjediset dhe kategoritë jo skamnore për nga burimet ekonimike, por të ekspozuara ndaj dëshpërimit të moskuptimësisë, ndaj tinëzisë së drogës, ndaj braktisjes në moshë të moshuar ose në sëmundje, ndaj mënjanimit ose diskriminimit shoqëror. I krishteri, që jepet mbi këtë skenar, duhet të mësojë të bëjë punën e vet të fesë në Krishtin, duke ia deshifruar thirrjen që ai dërgon nga kjo botë e varfërisë. Bëhet fjalë për të vazhduar një traditë dashurie që ka pasur tashmë në dymijë vjetët e kaluar shprehje të shumëta, por që sot ndoshta rikërkon një forcë shpikjeje akoma më të madhe. Është ora e një “fantazie të re të dashurisë”, që të shpaloset joaq e jo vetëm në efektshmërinë e ndihmave që jepen, por në aftësinë për t’u bërë të afërt, solidarë me kë vuan, kështu që gjesti i ndihmës të ndihet jo si një grosh poshtëruës, por si bashkëndarje vëllazërore.

Duhet për këtë të bëjmë në mënyrë që të varfërit të ndihen, në çdo bashkësi të krishterë, si “në shtëpi të tyre”. A nuk do të ishte, ky stil, paraqitja më e madhe dhe më me efekt e lajmit të mirë të Mbretërisë? Pa këtë formë ungjillizimi, të kryer përmes dashurisë dhe dëshmisë së varfërisë së krishterë, shpallja e Ungjillit, që është edhe bamirësia e parë, rrezikon të mbetet e pakuptuar ose të

zhytet në atë det fjalësh ku na ekspozon përditë shoqëria e sotme e komunikimit. Dashuria e *veprave* i siguron një forcë të padykuptimtë dashurisë së *fjalëve*.

### ***Sfidat e sotme***

51. E si të mbetemi mënjanë përballë perpektivave të një çrregullimi ekologjik, që i bën jo mikpritëse dhe armike të njeriut zona të mëdha të planetit? Ose lidhur me problemet e paqes, shpesh të kërcënuar me makthin e luftërave katastrofike? Ose përballë përçmimit të të drejtave njerëzore themelore të shumë personave, veçanërisht të fëmijëve? Të shumta janë urgjencat, ndaj të cilave shpirti i krishterë nuk mund të mbesë i pandjeshëm.

Një angazhim i posaçëm duhet të lidhet me disa aspekte të rrënjësisë ungjillore që janë shpesh më pak të kuptuara, deri aty sa ta bëjnë jopopullore ndërhyrjen e Kishës, por që nuk mundet për këtë të jenë më pak të pranishme në axhendën kishtarë të dashurisë. I referohem detyrës për t'u angazhuar për respektimin e jetës së çdo qenieje njerëzore, nga ngjizja deri në perëndimin e saj të natyrshëm. Në të njëjtën mënyrë, shërbimi ndaj njeriut na mbivë të thërrasim, me vend e pa vend, se ata që përdorin potencialitetet e reja të shkencës, veçanërisht mbi terrenin e bioteknologjive nuk mundet kurrë të mosvërejnë kërkesat themelore të etikës, ndoshta duke iu drejtuar një solidariteti të diskutueshëm, që përfundon duke diskriminuar midis një jete dhe një tjetre, në dëm të dinjitetit vetjak të çdo qenieje njerëzore.

Për efektshmërinë e dëshmisë së krishterë, veçanërisht në këto mjedise delikate dhe kundërshtore, është e rëndësishme të bëhet një përpjekje e madhe për të shpjeguar në mënyrë të mjaftueshme motivet e pozicionit të Kishës, duke nënvizuar kryesisht se nuk bëhet fjalë për t'u mbivënë mosbesimtarëve një perspektivë feje, por për të interpretuar dhe mbrojtur vlerat e rrënjësura në vetë natyrën e qenies njerëzore. Dashuria do të bëhet atëherë domosdoshmërisht shërbim ndaj kulturës, politikës, ekonomisë, familjes, kështu që gjithëkund të respektohen parimet themelore prej të cilave varet fati i qenies njerëzore dhe e ardhmja e qytetërimit.

52. Gjithë kjo natyrisht do të duhet të realizohet me një stil specifik të krishterë: do të jenë sidomos *laikët* ata që do të bëhen të pranishëm në këto detyra në përmbushje të thirrjes vetjake të tyre, pa rënë kurrë në tundimin që t'i rrëgjojnë bashkësitë e krishtera në agjenci sociale. Në veçanti, raporti me shoqërinë civile do të duhet të shëmbëllet në mënyrë që të respektojë autonominë dhe kompetencat e kësaj të fundit, sipas mësimin të propozuar nga *doktrina shoqërore e Kishës*.

Është e njohur përpjekja që Magjisteri kishtar ka kryer sidomos në shekullin XX, për të lexuar realitetin shoqëror nën dritën e Ungjillit dhe për të ofruar në mënyrë gjithnjë e më të përpiktë dhe organike kontributin e vet ndaj zgjidhjes së çështjes sociale, të bërë tashmë një çështje planetare.

Kjo anë etiko-shoqërore propozohet si përmasë e papërrjashtueshme e dëshmisë së krishterë: duhet shtyrë

tej tundimi i një shpirtërie intimistike dhe individualistike, që keq do të bashkëvendosej me kërkesat e dashurisë, përveçse me logjikën e Mishërimit dhe, përfundimisht, me vetë tensionin eskatologjik të krishtërit. Nëse ky i fundit na bën të vetëdijshëm për karakterin relativ të historisë, kjo nuk vlen për të na çangazhuar në ndonjë farë mënyre nga detyra për ta ndërtuar. Mbetet më shumë se kurrë aktual, lidhur me këtë, mësimi i Konçilit Vatikan II: “Mesazhi i krishterë, larg prej së shkëputuri njerëzit nga detyra për të ndërtuar botën, larg prej së nxiturit ata për t’u çinteresuuar për të mirën e të ngjashmëve të vet, i angazhon për më tepër për të gjitha këto me një detyrim akoma më shtrëngues”.<sup>36</sup>

### *Një shenjë konkrete*

53. Për të dhënë një shenjë të këtij udhërrëfimi dashurie dhe promovimi njerëzor, që rrënjëson në kërkesat intime të Ungjillit, kam dashur që vetë Viti jubilar, ndër frytet e numërta të dashurisë që ka prodhuar tashmë përgjatë zhvillimit të tij – mendoj, në veçanti, për ndihmën e ofruar nga shumë vëllezër më të varfër për t’u lejuar atyre që të merrnin pjesë në Jubile – të linte edhe një vepër që të përbente, në një farë mënyre, *frytin dhe vulën e dashurisë jubilarë*. Shumë shtegtarë në fakt, kanë derdhur në mënyra të ndryshme leptën e tyre dhe, së bashku me ta, edhe shumë protagonistë të veprimtarisë ekonomike kanë ofruar mbështetje bujare, që kanë

---

<sup>36</sup> Kusht. Bar. Mbi Kishën në botën baskëkohore *Gaudium et spes*, 34.

shërbyer për të realizuar një realizim të volitshëm të ngjarjes jubilarë. Si të jenë shlyer llogaritë e shpenzimeve që ka qenë nevojshme të përballohen përgjatë vitit, paraja që do të ketë qenë e mundur të kursehet do të duhet të shkojë për qëllim bamirësie. Është e rëndësishme në fakt që nga një ngjarje religjioze aq kuptimplote të largohet çdo hije spekulimi ekonomik. Ajo që do të mbiteprojë do të shërbejë për të përsëritur edhe në këtë rrethanë përvojën e jetuar shumë herë të tjera përgjatë historisë, që kur, në fillimet e Kishës, bashkësia e Jerusalemit u ofroi jo të krishterëve shfaqjen prekëse të një shkëmbimi spontan dhuratash, deri në përbashkësinë e të mirave, në përkrahje të më të varfërve (krh At 2,44-45).

Vepra që do të realizohet do të jetë vetëm një përrua i vogël që do të bashkëderdhet në detin e madh të dashurisë së krishterë që përshkon historinë. I vogël, por përrua kuptimplotë: Jubileu e ka shtyrë botën të vështrojë drejt Romës, Kishës “që prin në dashuri”<sup>37</sup> dhe për t’i sjellë Pjetrit leptën e vet. Tani dashuria e manifestuar që qendrën e katolicitetit kthehet, në ndonjë mënyrë, përkundraill botës përmes kësaj shenje, që do të mbesë si fryt dhe kujtesë e gjallë e bashkimit të eksperimentuar me rastin e Jubileut.

---

<sup>37</sup> Sh. Injaci i Antiokisë, Letra drejtuar Romakëve, Parath., bot. Funk. I, 252.

### ***Dialog dhe mision***

54. Një shekull i ri, një mijëvjeçar i ri hapen në dritën e Krishtit. Por jo të gjithë e shohin këtë dritë. Ne kemi detyrën e mahnitshme dhe kërkuese për të qenë “refleksi”. Është *mysterium lunae* kaq i dashur për kundrimin e Etërve, të cilët dëftonin me këtë imazh varësinë e Kishës nga Krishti, Diell, dritën e të cilit ajo reflekton.<sup>38</sup> Ishte një mënyrë për të shprehur çka Krishti vetë thotë, duke u paraqitur si “dritë e botës” (Gjn 8,12) e duke u kërkuar njëkohësisht dishepujve e tij të jenë “drita e botës” (Mt 5,14).

Është një detyrë kjo, ëq na bën të drithërohemi, nëse vështrojmë për nga dobësia që na bën aq shpesh opakë e plot me hije. Por është detyrë e mundshme, nëse duke u ekspozuar ndaj dritës së Krishtit, dimë t’i hapemi hirit që na bën njerëz të rinj.

55. Është në këtë vështrim që vendoset edhe sfida e madhe e *dialogut ndërreligjioz*, në të cilin shekulli i ri do të na shohë ende të angazhuar, në linjën e dëftuar nga Konçili Vatikan II.<sup>39</sup> Në vitet që kanë përgatitur Jubilen e Madh Kisha është orvatur, edhe me takime të një peshe të konsiderueshme simbolike, të përvijojë *një raport hapjeje e dialogu me eksponente religjionesh të tjera*. Dialogu

---

<sup>38</sup> Kështu për shembull, Shën Agustini: “*Luna intellegitur Ecclesia, quod suum lumen non habeat, sed ab Unigenito Dei Filio, qui multis locis in Sanctis Scripturis allegorice sol appellatus est*”: Enarr. In Ps 10,3: CCL 38, 42.

<sup>39</sup> Krh Dekl. mbi marrëdhëniet e Kishës me religjionet e jokrishtera *Nostra aetate*.



duhet të vazhdojë. Në kushtet e një pluralizmi më të spikatur kulturor e religjioz, ashtu siç është duke u paraqitur në shoqërinë e mijëvjeçarit të ri, një dialog i tillë është i rëndësishëm edhe për të vendosur një parakusht të sigurtë paqeje dhe për të larguar fantazmën e trishtë të luftërave ndërreligjioze që kanë larë me gjak shumë periudha të historisë së njerëzimit. Emri i Hyjit të vetëm duhet të bëhet gjithnjë e më shumë, siç është, *një emër paqeje dhe një urdhërues paqeje*.

56. Por dialogu nuk mund të themelohet mbi indiferentizmin religjioz, dhe ne të krishterët kemi detyrën ta zhvillojmë duke ofruar dëshminë e plotë të shpresës që është në ne (krh 1 Pt 3,15). Nuk duhet të kemi frikë se mund të përbëjë ofendim për identitetin e tjetërkujt çka në të vërtetë është lajm i gëzueshëm i një dhurate që është për të gjithë, e që u duhet propozuar të gjithëve me respektin më të madh për lirinë e secilit: dhurata e zbulimit të Hyjit-Dashuri që “aq shumë e deshi botën sa që e dha një të vetmin Birin e vet” (Gjn 3,16). Gjithë kjo, siç ka qenë edhe nënvizuar rishtas nga Deklarata *Dominus Jesus*, nuk mund të jetë objekt i një lloj traktative dialoguese, gati sikur të ishte për ne një opinion i thjeshtë: kurse është për ne hir që na mbush me gëzim, është lajm që kemi detyrën ta njoftojmë.

Kisha, ndërkohë, nuk mund të shmanget nga detyra misionare kundrejt popujve, dhe mbetet detyrë parësore e *missio ad gentes* njoftimi që është në Krishtin, “Udha, e Vërteta dhe Jeta” (Gjn 14,6), se njerëzit gjejnë shpëtimin. Dialogu ndërreligjioz “nuk mundet thjesht të zëvendësojë

shpalljen, por mbetet i orientuar kundrejt shpalljes.”<sup>40</sup> Detyra misionare, nga ana tjetër, nuk na pengon për të shkuar në dialog *brendësisht të disponueshëm për dëgjim*. Dimë në fakt se, përballë misterit të hirit pafundësisht të pasur në përmasa dhe përmbajtje për jetën dhe historinë e njeriut, vetë Kisha nuk do të reshtë kurrë së hulumtuari, duke llogaritur tek ndihma e Ngushëlluesit, Shpirtit të së vërtetës (krh Gjn 14,17), të cilit pikërisht i përket ta çojë tek “plotësia e së vërtetës” (krh Gjn 16,13).

Ky parim është në bazën jo vetëm të thellimit teologjik të pashtershëm të së vërtetës së krishterë, por edhe të dialogut të krishterë me filozofitë, kulturat, religionet. Jo rrallë Shpirti i Hyjit, që “fryn atje ku do” (Gjn 3,8) ngjall në përvojën njerëzore universale, megjithë kontradiktat e saj të shumëfishta, shenja të pranisë së tij, që i ndihmojnë vetë dishepujt e Krishtit për të kuptuar më thellë mesazhin bartës të të cilit janë. A mos nuk ka qenë me këtë hapje të përvuajtur e besimplotë që Konçili Vatikan II është angazhuar për të lexuar “Shenjat e kohëve?”<sup>41</sup> Gjithë duke zbatuar një shoshitje vepruese e vigjilente për të kapur “shenjat e vërteta të pranisë ose të planit të Hyjit”,<sup>42</sup> Kisha pranon

---

<sup>40</sup> Instr. Mbi shpalljen e Ungjillit dhe dialogun ndërreligjioz i Këshillit Pontifik për Dialogun Ndërreligjioz dhe i Kongregatës për Ungjillizimin e Popujve, *Dialog e shpallje: reflektime e orientime* (19 maj 1991), 82: AAS 84 (1992),444.

<sup>41</sup> Krh Kusht. bar. mbi Kishën në botën bashkëkohore *Gaudium et spes*, 4.

<sup>42</sup> *Po aty*, 11.

së nuk ka vetëm dhënë, por edhe “marrë nga historia dhe nga zhvillimi i llojit njerëzor”<sup>43</sup> Këtë qëndrim hapjeje dhe njëkohësisht shoshitjeje të vëmendshme Konçili e ka inauguruar edhe kundrejt religjionesh të tjera. Na përket ne t’ia ndjekim mësimin dhe gjurmën me besnikëri të madhe.

### *Në dritën e Konçilit*

57. Sa pasuri, shumë të dashur Vëllezër e Motra, në orientimet që Konçili Vatikan II na ka dhënë! Për këtë, në përgatitje të Jubileut të Madh, i kam kërkuar Kishës të *pyetet mbi marrjen vesh të Konçilit*.<sup>44</sup> A ka qenë bërë? Kuvendi që është mbajtur këtu në Vatikan ka qenë një moment i këtij reflektimi, dhe urohëm që po ashtu të jetë bërë, në mënyra të ndryshme, në të gjitha Kishat e veçanta. Dora dorës që kalojnë vitet, ato tekste nuk e humbin vlerën e tyre as shkëlqimin e tyre. Është e nevojshme që ato të lexohen në mënyrë të përshtatshme, që të bëhen të njohura dhe të asimilohen, si tekste cilësore dhe normative të Magjisterit, në brendësi të Traditës së Kishës. Me Jubile të përfunduar ndjej më shumë se kurrë detyrën për ta treguar Konçilin, si *hirin e madh prej të cilit Kisha është mirëbërë në shekullin XX*: në të na është ofruar një busull për të na orientuar në ecjen e shekullit që hapet.

---

<sup>43</sup> *Po aty*, 44.

<sup>44</sup> Krh Let. Ap. *Tertio millennio adveniente* (10 nëntor 1994), 36: AAS 87 (1995), 28.

## PËRFUNDIM DUC IN ALTUM!

58. Të shkojmë përpara me shpresë! Një mijëvjeçar i ri hapet përpara Kishës si një oqean i gjerë në të cilin të aventurohemi, duke llogaritur mbi ndihmën e Krishtit. Biri i Hyjit, që është mishëruar ka tashmë dymijë vjet për dashuri të njeriut, e kryen edhe sot veprën e vet: duhet të kemi sy depërtues për ta parë, dhe sidomos një zemër të madhe për t'u bërë vetë ne vegla të tij. A mos nuk ka qenë për të rimarrë kontakt me këtë burim të gjallë të shpresës sonë, që kemi kremtuar Vitin jubilar? Tani Krishti i kundruar dhe dashur na fton edhe një herë për t'u vënë në ecje: “Prandaj shkoni e bëni nxënës të mi të gjithë popujt! Pagëzoni në emër të Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjt.” (Mt 28,19). Mandati misionar na fut në mijëvjeçarin e tretë duke na ftuar për të njëjtin entuziazëm që karakterizoi të krishterët e kohës së parë: mund të llogarisim mbi forcën e të njëjtit Shpirt, që qe ndikuar për Rrëshajë dhe na shtyn sot të rinisemi të mbështetur nga shpresa “që nuk zhgënjën” (Rm 5,5).

Hapi ynë, në fillim të këtij shekulli të ri, duhet të bëhet më i shpejtë në ripërshkimin e rrugëve të botës. Udhët e tij mbi të cilat secili prej nesh, dhe secila prej Kishave tona ecën, janë të shumta, por nuk ka largesë midis atyre që janë të shtrënguar së bashku nga i njëjti bashkim: bashkimi që çdo ditë ushqehet në tryezën e Bukës eukaristike dhe të Fjalës së jetës. Çdo të dielë,

Krishti i ringjallur na rijep një takim si në Çenakull, ku në mbrëmjen e “ditës së parë pas së shtunës” (Gjn 20,19) iu paraqit të tijve për të “hukatur” mbi ta dhuratën gjallëruese të Shpirtit dhe për t’i nisur për aventurën e madhe të ungjillizimit.

Na shoqëron në këtë ecje Virgjëra e Shenjtë, së cilës, ka ndonjë muaj, së bashku me shumë Ipeshkvi të mbledhur në Romë nga të gjitha anës e botës, i kam besuar mijëvjeçarin e tretë. Shumë herë në këto vite e kam paraqitur dhe bëzajtur si “Yll i ungjillizimit të ri”. E dëftoj ende, si agun e ndritshëm dhe prijësen e sigurtë të ecjes sonë. “Grua, ja bijtë e tu”, i përsëris, duke rijehuar vetë zërin e Jezusit (krh Gjn 19,26), dhe duke u bërë zëri, pranë saj, i ndjenjave birnore të gjithë Kishës.

59. Shumë të dashur Vëllezër e Motra! Simboli i Portës së Shenjtë na mbyllet pas shpine, por vetëm për ta lënë të hapur në kanata portën e gjallë që është Krishti. Nuk është tek një gri i përditshëm që ne kthehemi, pas entuziazmit jubilar. Përkundrazi, nëse i përnjëmendtë ka qenë shtegtimi ynë, ai i ka disi shmpirë këmbët tona për ecjen që na pret. Duhet të imitojmë hovin e apostullit Pal: “harroj çka kam lënë pas dhe zgjatëm drejt së ardhmes, sulem drejt qëllimit, drejt shpërblimit të thirrjes qiellorë të Hyjit në Krishtin Jezus” (Fil 3,13-14).

Duhet të imitojmë së bashku kundrimin e Marisë, që, pas shtegtimin në qytetin e shenjtë të Jerusalemit, kthehej në shtëpinë e Nazaretit duke medituar në zemrën e saj misterin e Birit (krh Lk 2,51).

Jezusi i ringjallur, që na shoqërohet neve në rrugët tona, duke u lënë të njihet, si nga dishepujt e Emmausit “në thyerjen e bukës” (Lk 24,35), na gjettë vigjilentë dhe të gatshëm për të njohur fytyrën e tij dhe për të rendur tek vëllezërit tanë duke sjellë lajmin e madh: “Kemi parë Zotin!” (Gjn 20,25).

Është ky fryti shumë i uruar i Jubileut të Vitit Dymijë, Jubileut që ka ripropozuar gjallazi për sytë tanë misterin e Jezusit të Nazaretit, Bir i Hyjit dhe Shëlbues i njeriut. Ndërsa ai përmbillet dhe na hap ndaj një të ardhmeje shprese, të ngjitet tek Ati, përmes Krishtit, në Shpirtin Shenjt, lavdi dhe falenderimi i të gjithë Kishës.

Me këtë urim ju dërgoj të gjithëve nga thellësia e zemrës Bekimin tim.

*Nga Vatikani, më 6 janar, e Kremte e Dëftimit të Zotit, e vitit 2001, i njëzetetreti i Pontifikatit.*